




NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



RESPUBLICA



E DREJTA E INFORMIMIT

Transparencë në vitrinë. Po në praktikë?

2025

2020

2021

2022

2023

2024

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet se reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autor:

Av. Dorian Matlija

Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktor: Dorian Matlija

Tirazhi: 200 kopje

Kopertina: ChatGPT

E DREJTA E INFORMIMIT 2025

Transparencë në vitrinë. Po në praktikë?

PËRMBAJTJA

7 Hyrje

9 Metodologjia

9 Monitorimi i transparencës proaktive

11 Monitorimi i transparencës reaktive

11 Monitorimi i veprimtarisë së Komisionerit

12 Të dhënat e hapura

13 Transparenca e Autoriteteve publike

13 Transparenca proaktive

13 *Programet e transparencës*

18 *Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve*

19 *Koordinatorët për të drejtën e informimit*

20 Sjellja e institucioneve ndaj kërkesave për informacion

21 *Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare*

22 *Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare*

23 *Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ*

24 *Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ*

25 *Vlerësim agregat*

26 Komisioneri për të Drejtën e Informimit

27 Rezoluta e Kuvendit

27 Statistika nga veprimtaria e Komisionerit

27 *Numri i ankesave drejtuar Komisionerit*

28 *Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit*

29 *Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri*

31 *Llojet e vendimeve*

32 *Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri*

33 *Aplikimi i sanksioneve*

37 Aspekte të veçanta për vitin 2025

37 Ndërthurja midis Planit të Integritetit dhe zbatimit të së drejtës për informim

38 Konferenca Kombëtare për të Drejtën e Informimit – një analizë në dy plane

40 Platforma “Transparent Albania”

41 Konventa e Tromsos dhe fillimi i monitorimit ndërkombëtar

41 Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit në sektorin publik

42 Agjencia për Media dhe Informim

43 Akses në regjistrimet audiovizuale të seancave publike – rasti M.M.

44 Akses në relacionet shpjeguese të vendimeve të Këshillit të Ministrave

45 Transparenca në lejet e ndërtimit dhe dokumentacionin shoqërues – rasti i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit

46 Mbyllja e praktikave nga Komisioneri pa verifikim – rasti Res Publica kundër Komisionerit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

47 Kufizimi i transparencës për shkak të proceseve gjyqësore – rasti i Bashkisë Himarë

48 Transparenca e vonuar dhe dëmshpërblimi për mosinformim – rasti i gazetarit A.R. kundër Bashkisë Librazhd

49 Të dhëna nga platforma “Publeaks.al”

54 Konkluzione

57 Rekomandime

I. HYRJJE

Ky raport është hartuar nga Qendra Res Publica, me mbështetjen bujare të National Endowment for Democracy (NED), si pjesë e projektit “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit në Shqipëri”. Pas vitit 2024, i cili shënoi dhjetëvjetorin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, viti 2025 paraqitet si një moment i rëndësishëm për të vlerësuar jo më thjesht potencialin teorik të këtij ligji, por efektet e tij konkrete në praktikën administrative dhe institucionale. Ndryshimet e miratuara në vitin 2023 krijuan pritshmërinë se kuadri ligjor do të bëhej më efektiv në garantimin e transparencës, ndaj ky vit përbën një provë të vlefshme për të parë nëse kjo pritshmëri është përkthyer në përmirësim real.

Që prej miratimit të ligjit në vitin 2014, Res Publica ka mbajtur në vëzhgim të vazhdueshëm mënyrën se si ai zbatohet në praktikë, duke testuar si transparencën proaktive, përmes publikimit dhe përditësimit të programeve të transparencës, ashtu edhe transparencën reaktive, pra mënyrën se si autoritetet publike u përgjigjen kërkesave konkrete për informacion. Edhe gjatë vitit 2025, monitorimi është mbështetur në të njëjtën metodologji krahasuese të përdorur ndër vite: janë monitoruar 100 autoritetet publike më të rëndësishme dhe janë depozituar 200 kërkesa për informacion, që prekin fusha me interes të lartë publik, si mjedisi, ndërtimi, ekonomia, drejtësia, shëndetësia dhe prokurimet publike.

Të dhënat e këtij viti tregojnë një përmirësim të moderuar në sjelljen fillestare të institucioneve ndaj kërkesave për informacion. Nga 200 kërkesa të monitoruara, 65% kanë marrë përgjigje të plotë, 16% përgjigje të pjesshme dhe 19% kanë mbetur pa përgjigje. Njëkohësisht, koha mesatare e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare ka zbritur në 16 ditë kalendarike, ndërsa pas ankimit administrativ reagimi mesatar i institucioneve ka rënë në 12 ditë të tjera kalendarike, që sipas të dhënave të mbledhura rezulton koha më e ulët e regjistruar në dhjetë vitet e fundit. Këto tregues sugjerojnë një lëvizje pozitive, por jo domosdoshmërisht një ndryshim të plotë të kulturës administrative ndaj transparencës.

Në të njëjtën kohë, raporti ndjek edhe rolin e autoritetit kujdestar, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të kuptuar sa efektivisht ndërhy

ai përballë vonesave, refuzimeve apo pengesave të pajustificuara. Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se pranë Komisionerit janë adresuar 861 ankesa, se janë marrë 33 vendime dhe se vetëm 2 raste kanë përfunduar me sanksion gjobë për refuzimin e dhënies së informacionit, si dhe 13 sanksione me gjobë për mosplotësim të programeve të transparencës. Kjo do të thotë se, edhe pse vërehen shenja përmirësimi në reagimin e disa institucioneve, mekanizmi mbikëqyrës mbetet ende për t'u testuar në aspektin e shpejtësisë, koherencës dhe efektit ndëshkues, sidomos për reagimin ndaj kërkesave për informacion.

Viti 2025 nuk u karakterizua vetëm nga të dhënat e monitorimit. Ai shënoi edhe vazhdimin e një narrative institucionale që e paraqet transparencën si pjesë të agjendës së integritetit dhe të integritetit evropian. Në dhjetor 2025 u zhvillua Konferenca e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit, e organizuar si pjesë përmblylëse e “Javës së Integritetit”, ku u theksuan roli mbikëqyrës i Komisionerit, përgjegjësia e institucioneve publike dhe forcimi i llogaridhënies ndaj qytetarëve. Po ashtu, Zyra e Komisionerit ka lidhur një pjesë të veprimtarisë së saj të vitit 2025 me detyrat e lëna nga rezoluta e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2024, ndonëse rezoluta nuk lë detyra për aspektin e të drejtës së informimit. Kjo e bën edhe më të nevojshëm një vlerësim kritik të hendekut të mundshëm midis retorikës publike mbi transparencën dhe rezultateve konkrete në terren.

Dokumenti nuk kufizohet vetëm në pasqyrimin e treguesve numerikë. Ai synon të vlerësojë edhe zhvillimet institucionale, narrative dhe jurisprudenciale që kanë shoqëruar të drejtën e informimit gjatë vitit 2025. Për këtë arsye, përveç monitorimit të praktikës administrative, raporti analizon edhe përdorimin e platformës Publeaks.al, e cila që prej vitit 2016 ka shërbyer si një instrument praktik për qytetarët, gazetarët, studiuesit dhe aktivistët e shoqërisë civile. Sipas të dhënave të përfshira në materialin e këtij viti, përmes kësaj platforme janë regjistruar tashmë mbi 2800 kërkesa për informacion, përgjigjet e të cilave janë të aksesueshme për këdo.

Një vend të rëndësishëm në këtë raport zënë edhe rastet konkrete nga praktika administrative dhe gjyqësore, të cilat ilustrojnë se si qytetarë, gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile e kanë përdorur ligjin për të nxjerrë në dritë dokumente publike, për të sfiduar refuzimet arbitrare dhe për të ndërtuar standarde të reja në jurisprudencë.

Kësisoj, ky raport synon jo vetëm të evidentojë ecurinë e vitit 2025, por edhe të ofrojë një lexim më të gjerë mbi mënyrën se si transparenca promovohet, administrohet, interpretohet dhe herë pas here instrumentalizohet në Shqipëri. Ai është menduar si një mjet i dobishëm për gazetarët që hulumtojnë, për qytetarët që kërkojnë llogari, për juristët që mbrojnë të drejtën e informimit dhe për vendimmarrësit që synojnë një administratë më transparente, më të përgjegjshme dhe më pak të varur nga retorika formale e më shumë nga zbatimi real i ligjit.

Përgatitën raportin:

Av. Dorian Matlija
Dr. Irena Dule
Av. Brunilda Qershori

II. METODOLOGJIA

Monitorimi i zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është realizuar mbi baza krahasuese, duke analizuar performancën e autoriteteve publike gjatë vitit 2025 në raport me vitet paraardhëse. Për të ruajtur koherencën e të dhënave dhe vlefshmërinë e krahasimeve ndër vite, Res Publica ka përdorur të njëjtën metodologji monitorimi që prej vitit 2015 (së bashku me monitorimin e ligjit pararendës në vitin 2013), me përshtatje të kufizuara vetëm në nivel sqarues, pa cenuar thelbin e instrumenteve matëse.

Metodologjia e përdorur mbështetet në dy shtylla kryesore të ligjit: transparencën proaktive dhe transparencën reaktive. Përveç këtyre dy elementeve, raporti përfshin edhe monitorimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si organi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, si dhe një vlerësim të veçantë mbi publikimin e të dhënave të hapura (open data).

2.1. Monitorimi i transparencës proaktive

Ligji nr. 119/2014 i jep një rëndësi të veçantë transparencës proaktive, duke u kërkuar autoriteteve publike jo vetëm publikimin, por edhe përditësimin e vazhdueshëm të informacionit që duhet të vihet në dispozicion të publikut pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë për informacion. Ky detyrim buron nga neni 7 i ligjit, i cili përcakton kategoritë e informacionit që çdo autoritet publik duhet të publikojë në mënyrë të vazhdueshme në programin e transparencës dhe në faqen zyrtare të internetit.

Për realizimin e këtij monitorimi janë përzgjedhur 100 institucione publike, të ndara në 5 kategori kryesore:

- organet kushtetuese dhe të pavarura,
- pushteti ekzekutiv qendror,
- institucionet në varësi të pushtetit ekzekutiv,
- pushteti vendor,
- sistemi i drejtësisë.

Nga secila kategori janë përzgjedhur 20 autoritetet publike më me peshë, me synimin për të pasur një kampion të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm ndër vite.

Për matjen e transparencës proaktive, Res Publica nuk është kufizuar në konstatimin formal nëse informacioni ekziston apo jo në faqen zyrtare të institucionit, por ka përdorur një sistem vlerësimi me pikë, të ndërtuar mbi rëndësinë relative të secilës kategori informacioni të parashikuar nga ligji. Kjo qasje buron nga fakti se jo të gjitha kategoritë e informacionit kanë të njëjtën vlerë praktike për publikun. Disa prej tyre kanë rëndësi thelbësore për llogaridhënien dhe aksesin efektiv në informacion, ndërsa disa të tjera kanë karakter më ndihmës ose informues.

Për këtë arsye, Res Publica ka ndërtuar një skemë pikëzimi me total 100 pikë, ku secila kategori informacioni është peshuar sipas rëndësisë së saj. Peshat relative të secilit element është përcaktuar mbi bazën e një procesi konsultimi me specialistë të fushës, gazetarë, avokatë, aktivistë dhe pedagogë, të cilët kanë dhënë vlerësim individual për secilën kategori informacioni. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve është nxjerrë një mesatare, me synimin për të arritur një ekuilibër sa më objektiv në peshimin e secilit detyrim ligjor.

Analiza e skemës së pikëzimit nuk i jep peshë kryesore numrit të kategorive të informacionit të publikuar, por rëndësisë së transparencës reale. Në këtë kuptim, një grup i kufizuar indikatorësh, si caktimi dhe roli i koordinatorit për të drejtën e informimit, funksionaliteti i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe publikimi i informacionit të detajuar mbi prokurimet, kontratat dhe vendimmarrjen, mbartin një peshë më të lartë në total sesa numri i kategorive të tjera të informacionit.

Konkretisht, komponentët që lidhen me transparencën substanciale dhe të përdorshme (si prokurimet, të dhënat mbi funksionarët, mekanizmat e kontrollit dhe aksesueshmëria reale e informacionit) kanë një vlerësim të agreguar shumë më të lartë sesa elementët më formalë të transparencës, si publikimi i akteve ligjore, informacionet orientuese për publikun apo të dhënat organizative bazë. Kjo do të thotë se, edhe pse në dukje grupi i dytë përfshin më shumë kategori dhe shkronja sipas strukturës së nenit 7 të ligjit, ndikimi i tij në rezultatin përfundimtar është më i kufizuar.

Vlerësimi nuk është bërë vetëm mbi praninë formale të informacionit, por edhe mbi aktualitetin e tij. Çdo informacion i papërditësuar i nënshtrohet uljes graduale të pikëve.

Autoritetet që arrijnë një nivel të lartë pikësh konsiderohen se kanë një përmbushje të kënaqshme, çka nënkupton se ato publikojnë në mënyrë të rregullt dhe të plotë informacionin kryesor që lidhet me funksionimin, vendimmarrjen dhe përdorimin e burimeve publike.

Një kategori e dytë përfshin autoritetet që plotësojnë vetëm pjesërisht këto detyrime. Në këto raste, transparenca është e fragmentuar, shpesh e kufizuar në elementë formalë ose e papërditësuar, duke mos garantuar akses të plotë dhe funksional për publikun.

Ndërsa në nivelin më të ulët renditen institucionet që nuk përmbushin detyrimet bazë të transparencës, qoftë për shkak të mungesës së publikimit të informacionit, qoftë për shkak të mungesës së një faqeje zyrtare. Në këto raste, transparenca proaktive mbetet thuajse inekzistente dhe qytetarët nuk kanë mundësi reale për të aksesuar informacionin publik pa ndjekur procedura të tjera.

Kjo metodë është përdorur rregullisht çdo vit që nga viti 2015, duke krijuar kështu një bazë të qëndrueshme krahasimore për të vlerësuar tendencat e institucioneve në kohë.

2.2. Monitorimi i transparencës reaktive

Për të matur transparencën reaktive, Res Publica ka përdorur si kampion 200 kërkesa për informacion të ndjekura gjatë vitit 2025, me të njëjtën praktikë të përdorur edhe në vitet paraardhëse. Kërkesat janë hartuar për të testuar sjelljen reale të institucioneve ndaj publikut dhe kanë mbuluar fusha të ndryshme me interes publik, si mjedisi, ekonomia, kultura, rindërtimi, prokurimet publike, shëndetësia, drejtësia dhe çështje të tjera me rëndësi publike.

Kërkesat u janë drejtuar autoriteteve publike të kategorive të ndryshme, përfshirë autoritete të pushtetit qendror, pushtetit vendor, institucione të drejtësisë, organe të pavarura dhe institucione në varësi të ekzekutivit. Synimi ka qenë që përmes një shpërndarjeje sa më të larmishme të vlerësohet në mënyrë sa më përfaqësuese kultura administrative e transparencës.

Për secilën kërkesë janë marrë në konsideratë këta tregues:

- koha e kthimit të përgjigjes;
- mënyra e reagimit të institucionit;
- plotësia e përgjigjes;
- mungesa e përgjigjes;
- nevoja për paraqitjen e ankimit administrativ;
- reagimi i institucionit pas ankimit;
- koha e reagimit pas ankimit.

Për të siguruar një vlerësim sa më të saktë të sjelljes, metodologjia ka marrë në konsideratë edhe kufizimet praktike që lidhen me kohën e qarkullimit të shkresave dhe komunikimin administrativ. Në këtë kuadër, ankimet administrative nuk janë depozituar menjëherë pas përfundimit të afatit minimal ligjor për përgjigje, por pas një periudhe të arsyeshme shtesë, me qëllim shmangien e rasteve kur një përgjigje e vonuar për arsye teknike ose procedurale mund të interpretohej si mungesë përgjigjeje.

Njëkohësisht, për të ruajtur integritetin e analizës dhe për të mos atribuar në mënyrë artificiale efektet e ankimit, është bërë një dallim i kujdesshëm midis përgjigjeve që lidhen realisht me ndërhyrjen e këtij mekanizmi dhe atyre që janë rezultat i proceseve të zakonshme administrative. Për këtë arsye, përgjigjet e dhëna në një interval shumë të afërt kohor me depozitimin e ankimit nuk janë konsideruar automatikisht si pasojë e tij, por janë trajtuar si raste të mundshme përkimi kohor.

Kjo qasje metodologjike synon të shmangë si nënvlerësimin e përgjigjeve të institucioneve, ashtu edhe mbivlerësimin e rolit të ankimit administrativ, duke ofruar një analizë më të balancuar dhe më pranë realitetit të funksionimit të administratës publike.

2.3. Monitorimi i veprimtarisë së Komisionerit

Një komponent më vete i metodologjisë ka qenë monitorimi i veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Për vitin 2025, njësoj si në vitet e mëparshme, janë analizuar të dhënat që lidhen me:

- numrin e ankesave të paraqitura pranë këtij institucioni;
- profilin e ankuesve;
- mënyrën e disponimit të ankesave;
- llojet e vendimeve të marra;
- aplikimin e sanksioneve administrative me gjobë;
- afatin brenda të cilit janë marrë vendimet.

Këto të dhëna janë krahasuar me vitet paraardhëse, me qëllim që të krijohet një panoramë më e gjerë dhe më e qëndrueshme mbi efektivitetin institucional të mekanizmit administrativ të ankimit.

Në vijim, është realizuar edhe një krahasim sistematik midis të dhënave të mbledhura përmes monitorimit dhe informacionit të raportuar nga vetë Komisioneri, me qëllim verifikimin e nivelit të përputhjes ndërmjet burimeve, si dhe të identifikimit të mospërputhjeve të mundshme në treguesit kryesorë të performancës. Në këtë mënyrë, analiza nuk është kufizuar vetëm në përshkrimin e të dhënave, por ka shërbyer edhe si instrument verifikimi dhe kontrolli të raportimit institucional.

Qasja krahasuese ka bërë të mundur evidentimin e disa tendencave dhe sinjaleve problematike (të quajtura “flamuj të kuq” në këtë raport), të cilat lidhen me mospërputhje në nivelin e raportimit, diferenca në mënyrën e klasifikimit të rasteve apo mungesë transparence mbi disa elementë të procesit vendimmarrës. Identifikimi i këtyre elementëve ka ndihmuar në një vlerësim më kritik të funksionimit të institucionit, duke nxjerrë në pah jo vetëm performancën formale, por edhe hendeqet në praktikë dhe në llogaridhënie.

Kjo metodologji e kombinuar, që ndërthur monitorimin e pavarur me analizën e raportimit zyrtar, synon të ofrojë një pasqyrë më të plotë dhe më të besueshme mbi efektivitetin e rolit të Komisionerit si garant i së drejtës për informim.

2.4. Të dhënat e hapura

Një pjesë e metodologjisë kohët e fundit i kushtohet edhe vlerësimin të të dhënave të hapura (open data), si një dimension i veçantë i transparencës proaktive. Kjo pjesë nuk kufizohet vetëm në ekzistencën formale të databazave ose dokumenteve të publikuara, por synon të vlerësojë nëse autoritetet publike publikojnë të dhëna në forma të aksesueshme, të ripërdorshme dhe realisht të dobishme për publikun, gazetarët, studiuesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në tërësi, metodologjia e përdorur në këtë raport synon të masë jo vetëm respektimin formal të detyrimeve ligjore, por edhe cilësinë reale të transparencës publike në Shqipëri. Ruajtja e së njëjtës metodologji ndër vite ka bërë të mundur ndërtimin e një serie krahasimore të qëndrueshme, e cila lejon identifikimin e progresit, mbetjes në vend apo regresit në sjelljen e institucioneve publike dhe të mekanizmave mbikëqyrës.

III. TRANSPARENCA E AUTORITETEVE PUBLIKE

Transparenca proaktive vijon të mbetet një nga shtyllat kryesore për vlerësimin e funksionimit real të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi ajo pasqyron jo vetëm përmbushjen formale të detyrimeve ligjore, por edhe nivelin e brendësimit të kulturës së llogaridhënies në administratën publike. Në këtë kuadër, edhe për vitin 2025 Res Publica monitoroi 100 autoritete publike të ndara në pesë kategori (20 autoritete kushtetuese dhe të pavarura, 20 autoritete të pushtetit ekzekutiv qendror, 20 autoritete të pushtetit ekzekutiv të varësisë, 20 autoritete të pushtetit vendor dhe 20 autoritete të sistemit të drejtësisë), duke vijuar metodologjinë e pandryshuar të përdorur që prej vitit 2015.

Gjetjet e këtij viti janë analizuar në mënyrë krahasimore me serinë historike të monitorimeve ndër vite, duke mundësuar identifikimin e tendencave afatgjata, si dhe dallimin midis përmirësimeve reale dhe atyre thjesht formale në zbatimin e transparencës proaktive.

3.1. Transparenca proaktive

a. Programet e transparencës

Që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 119/2014, programet e transparencës janë një nga indikatorët e besueshëm për të matur jo vetëm përmbushjen formale të detyrimeve ligjore, por mbi të gjitha mënyrën se si autoritetet publike e konceptojnë transparencën në praktikë. Ato përfaqësojnë pikën e parë të kontaktit mes institucionit dhe publikut, duke reflektuar nivelin e gatishmërisë për të publikuar informacion pa qenë e nevojshme nisma e qytetarëve përmes kërkesave individuale.


Monitorimet e viteve të para tregonin një situatë problematike, ku përmbushja e programeve të transparencës ishte minimale dhe në shumicën e rasteve thjesht formale. Vetëm rreth 18% e autoriteteve arrinin një nivel “të kënaqshëm”, ndërsa pjesa tjetër kufizohej në publikimin e dokumenteve bazike, shpesh të papërditësuara dhe pa vlerë reale për publikun. Në praktikë, programet e transparencës funksiononin më shumë si një detyrim burokratik sesa si një instrument i vërtetë llogaridhënieje.

Një ndryshim i dukshëm u shfaq pas vitit 2020, kur ndërhyrjet më aktive të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, të shoqëruara me aplikimin e sanksioneve administrative me gjobë, filluan të prodhojnë efekt konkret në sjelljen e institucioneve. Për herë të parë, transparencja proaktive nuk mbeti vetëm një kërkesë ligjore, por nisi të shoqërohej me pasoja reale në rast moszbatimi. Pikërisht në këtë periudhë vihet re një rritje e qëndrueshme e përbushjes së programeve, duke reflektuar reagimin e administratës ndaj presionit rregullator dhe publik.

Megjithatë, ky përmirësim duhet parë kryesisht në dimensionin sasior. Rritja e numrit të programeve të publikuara nuk është shoqëruar gjithmonë me një rritje të njëjtë të cilësisë së informacionit. Në shumë raste, autoritetet publike kanë përbushur detyrimin në mënyrë formale, duke publikuar struktura standarde pa përditësim të rregullt dhe pa përfshirë informacion me interes real publik. Kjo tregon se, edhe pse presioni institucional ka prodhuar përmirësime të dukshme, kultura e transparencës mbetet ende në zhvillim dhe nuk është brendësuar plotësisht si pjesë e funksionimit të përditshëm të administratës publike.

Në vitin 2025, niveli i përgjithshëm rezulton të jetë rritur në masën 61.2 nga 52.5% që ishte në 2024. Rritja vijon që prej 2021 kur nisi zbatimi i gjobave, siç duket nga grafiku më poshtë:


Fig. 1 - Përbushja e programeve të transparencës ndër vite (në %)



Në vitin 2025, ky trend vijon dhe bëhet më i konsoliduar në aspektin formal, duke treguar se shumica e autoriteteve publike kanë arritur të integrojnë programet e transparencës si pjesë të funksionimit të tyre rutinë. Ndryshe nga vitet e para, kur mungesa e programeve ishte problemi kryesor, fokusi tashmë zhvendoset drejt mënyrës se si këto programe zbatohen në praktikë dhe çfarë përmbytje reale ofrojnë për publikun.

Të dhënat e këtij viti tregojnë një nivel më të lartë përputhshmërie në dukje, ku pjesa dërrmuese e institucioneve kanë programe të publikuara dhe i përbushin ato në një masë të konsiderueshme. Kjo pasqyron një reagim të vazhdueshëm të administratës ndaj detyrimeve ligjore dhe presionit institucional, por njëkohësisht ngre pyetjen nëse ky përmirësim është reflektim i një ndryshimi të thellë në kulturën e transparencës apo thjesht një adaptim formal ndaj kërkesave të ligjit për shkak të presionit nga gjocat.

Fig. 2 - Shpërndarja e përbushjes së programeve të transparencës




Grafiku i mësipërm shfaq një përmirësim të mëtejshëm në aspektin sasior dhe konfirmon se faza fillestare e mungesës së programeve të transparencës, në pjesën më të madhe është tejkaluar. Transparenca proaktive është institucionalizuar deri në një farë mase si detyrim administrativ dhe nuk shihet më si një element dytësor apo opsional.

Megjithatë, një analizë më e thelluar e përmbajtjes dhe funksionimit të këtyre programeve tregon se progresi mbetet kryesisht në dimensionin formal. Në shumë raste, përmbushja e treguesve realizohet përmes publikimit të informacionit bazik, ndërsa elementët më të ndjeshëm dhe me interes real publik mbeten të kufizuar ose të paplotë. Programet shpesh përmbajnë të dhëna statike, të papërditësuara ose të strukturuar në mënyrë që nuk lehtëson përdorimin e tyre nga qytetarët.

Në këtë kuptim, rritja e përqindjeve nuk përkthehet automatikisht në rritje të transparencës reale.

Në vitin 2025, niveli i përmbushjes së programeve të transparencës sipas kategorive paraqitet si më poshtë:

Fig. 3 - Përmbushja e programeve të transparencës sipas kategorive të autoriteteve publike



Shpërndarja e mësipërme tregon një strukturë më të balancuar krahasuar me vitet e mëparshme, por gjithashtu nxjerr në pah disa tendenca të rëndësishme:


- Organet kushtetuese dhe ato të pavarura kryesojnë renditjen, duke reflektuar një nivel më të lartë përgjegjshmërie institucionale. Kjo është e dukshme gjatë gjithë viteve të fundit.
- Organet gjyqësore dhe ekzekutivi qendror paraqesin një performancë në rritje konstante, me rezultate të ngjashme midis tyre.
- Organet e pushtetit ekzekutiv qendror paraqesin një performancë me përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2025.
- Organet e varësisë të pushtetit ekzekutiv mbeten njëlloj si në vitin 2024, por me diferenca të forta brenda kategorisë.
- Pushteti vendor mbetet hallka më e dobët, pavarësisht një përmirësimi krahasuar me vitet e mëparshme.

Fig.4 - Shembujt pozitivë dhe negativë të vitit 2025

Kategoria	Shembuj pozitivë +	Shembuj negativë -
Autoritete të pavarur	Komisioneri për të Drejtën e Informimit Kuvendi Autoriteti i Kom. Elektronike e Postare	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Këshilli i Lartë i Prokurorisë Agjencia e Prokurimeve Publike
Pushteti ekzekutiv qendror	Ministria e Financave Ministria e Mbrojtjes Ministria e Ekonomisë	Ministria e Mjedisit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Autoritete të vartësisë	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Agjencia e Trajtim të Konkencioneve Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	Inspektoriati Qendror Agjencia e Inventarizimit të Pronave
Pushteti vendor	Bashkia Kukës Bashkia Korçë Bashkia Sarandë	Bashkia Krujë Bashkia Dibër Bashkia Himarë
Drejtesia	Gjykata e Lartë Prokuroria e Përgjithshme	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Gjykata e Rrethit Fier Gjykata e Rrethit Lezhë

Për të kuptuar më në thellësi cilësinë reale të transparencës proaktive, nuk mjafton vetëm vlerësimi i ekzistencës së programeve të transparencës, por është e nevojshme të analizohet edhe përmbajtja konkrete e tyre. Në këtë kuadër, monitorimi i vitit 2025 krahason edhe llojet e informacionit që institucionet zgjedhin të publikojnë, duke evidentuar diferencën midis informacionit formal, i cili publikohet në mënyrë të gjerë, dhe atij me interes të lartë publik, i cili shpesh mbetet i kufizuar. Grafiku në vijim paraqet nivelin e përmbushjes për secilin prej elementëve të programeve të transparencës, duke ofruar një panoramë më të qartë të prioriteteve reale të administratës në publikimin e informacionit.

Fi. 5 - Niveli i publikimit sipas llojit të informacionit



Krahasimi i të dhënave për vitet 2024 dhe 2025 për 18 nënkategoritë e informacionit të publikuar, tregon një përmirësim të përgjithshëm në shumicën dërrmuese të indikatorëve, por njëkohësisht nxjerr në pah disa pika regresi të rëndësishme në përmbajtje.

Në kategoritë bazike dhe më formale të informacionit vihet re një rritje e ndjeshme. Rritje të konsiderueshme janë regjistruar edhe në disa kategori funksionale, si dokumentet e kërkuara shpesh (nga 79% në 96%), apo struktura organizative (nga 72% në 81%). Këto tregues sugjerojnë një përmirësim gradual në aksesin ndaj informacionit pak më të përdorshëm për qytetarët, edhe pse kryesisht në dimensionin administrativ.

Megjithatë, kur kalojmë te informacionet me interes më të lartë publik, panorama bëhet më e fragmentuar. Disa indikatorë kanë shënuar përmirësim, si ndihma dhe subvencionet (nga 48% në 66%), apo buxheti dhe raportet financiare (nga 34% në 48%), duke treguar një hap përpara në transparencën e politikave publike. Nga ana tjetër, disa kategori vijnë të mbeten problematike ose madje kanë pësuar regres. Një nga rastet më të dukshme është ai i informacionit mbi arsimin, kualifikimin dhe pagat e funksionarëve, i cili ka rënë nga 37% në 26%, duke reflektuar ndikimin e ndryshimeve të shpeshta në drejtimin institucional dhe mungesën e përditësimit të të dhënave. Një rënie, edhe pse më e lehtë, vërehet edhe në procedurat e vendimmarrjes (nga 30% në 28%), duke treguar një dobësi të vazhdueshme në transparencën e proceseve vendimmarrëse.

Në disa indikatorë të tjerë, përmirësimi është i dukshëm por mbetet në nivele të ulëta absolute, si mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit (nga 23% në 27%), raportet e auditimit (nga 15% në 27%) dhe veçanërisht zbatimi dhe monitorimi i kontratave, i cili megjithëse është rritur nga 1% në 3%, mbetet praktikisht inekzistent si nivel transparence.

Një përmirësim relativisht i rëndësishëm vihet re në publikimin e të dhënave mbi prokurimet dhe kontratat (nga 24% në 41%), por edhe ky tregues mbetet larg standardeve të kërkuara për një transparencë efektive në përdorimin e fondeve publike.

Analiza cilësore tregon për progres formal, por me probleme reale

Edhe pse treguesit sasiorë të vitit 2025 paraqesin një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitet e para të zbatimit të ligjit, por edhe në raport me vitet e fundit, analiza cilësore e përmbajtjes së programeve të transparencës tregon se ky progres nuk është shoqëruar në të njëjtën masë me rritjen e transparencës reale. Në thelb, përmirësimi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të programeve të publikuara dhe përmbushjes së kërkesave minimale formale, ndërsa cilësia e informacionit të ofruar mbetet e kufizuar.

Në shumë raste, institucionet vijnë të publikojnë informacion bazik, të përgjithshëm ose të vjetëruar, i cili nuk i shërben realisht qytetarëve për të kuptuar vendimmarrjen, përdorimin e fondeve publike apo performancën institucionale. Kjo krijon një iluzion transparence, ku detyrimi ligjor duket se është përmbushur, por pa prodhuar vlerë konkrete për publikun.

Në këtë kontekst, transparenca proaktive mbetet e përqendruar kryesisht në elementë formalë, si kontaktet, procedurat apo dokumentet standarde, ndërsa informacioni me interes të lartë publik, si kontratat, mekanizmat e vendimmarrjes, monitorimi i performancës apo zbatimi i politikave, vijon të jetë i pjesshëm ose i munguar. Kjo tregon se administrata publike ka bërë hapa për t'u përshtatur me kërkesat e ligjit, por ende nuk ka arritur të transformojë transparencën në një praktikë të thellë dhe funksionale të llogaridhënies.

Në këtë kuptim, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se programet e transparencës janë tashmë më të konsoliduara si instrument formal në shumicën dërrmuese të autoriteteve publike, por sfida kryesore mbetet transformimi i tyre nga një detyrim burokratik në një mekanizëm real të llogaridhënies. Pavarësisht progresit në shifra, transparenca proaktive vazhdon të karakterizohet nga një diferencë e qartë midis përmbushjes formale dhe përmbajtjes reale, duke e bërë këtë komponent një nga pikat kyçe ku praktika administrative për transparencën mbetet ende në tranzicion.


b) Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Një nga elementët më të rëndësishëm të transparencës proaktive mbetet ekzistenca dhe funksionimi i regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, i cili synon të sigurojë akses të drejtpërdrejtë të publikut në informacionin e kërkuar më parë, pa qenë e nevojshme ndjekja e procedurave individuale. Ky mekanizëm është konceptuar si një instrument për të rritur efikasitetin administrativ, për të shmangur përsëritjen e kërkesave të ngjashme dhe për të forcuar llogaridhënien e institucioneve publike.

Megjithatë, monitorimet ndër vite tregojnë se zbatimi i këtij detyrimi ka qenë i vështirë dhe shpesh formal. Në vitet e para pas hyrjes në fuqi të ligjit (2015–2016), mbi 90% e autoriteteve publike nuk kishin një regjistër të publikuar. Një përmirësim i ndjeshëm u shënuar në vitin 2017, kur kjo shifër ra në rreth 47%, por pa u shoqëruar me një konsolidim të qëndrueshëm në vitet që pasuan. Nga viti 2018 deri në vitin 2020, progresi mbeti i kufizuar, duke reflektuar një frenim në përmbushjen e këtij detyrimi.

Një përmirësim më i qëndrueshëm nisi të evidentohet pas vitit 2021, kur përqindja e institucioneve pa regjistër ra ndjeshëm në 23%, dhe më tej në 20% në vitin 2023 dhe 18% në vitin 2024. Monitorimi i vitit 2025 konfirmon vazhdimin e këtij trendi pozitiv në aspektin sasior, ku 66% e institucioneve ofrojnë një regjistër të përmbushur në mënyrë të kënaqshme, 29% e institucioneve e përmbushin pjesërisht, ndërsa vetëm 7% rezultojnë pa regjistër ose pa akses real në të dhëna.

Fig. 6 - Përmbushja e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve



Këto shifra tregojnë se mungesa e regjistrit si dukuri është reduktuar ndjeshëm krahasuar me vite më parë dhe se ky instrument është tashmë i pranishëm në shumicën e institucioneve publike.

Megjithatë, një analizë më e thelluar tregon se problemi kryesor nuk lidhet më me ekzistencën e regjistrit, por me cilësinë dhe funksionalitetin e tij. Në praktikë, institucionet vijojnë të ndahen në disa kategori:

- një grup i kufizuar ofron akses të plotë në kërkesat dhe përgjigjet, duke përfshirë edhe dokumentacionin shoqëruar, ndonëse disa prej tyre kanë të dhëna të vjetra;
- një pjesë tjetër publikon vetëm përmbledhje minimale, shpesh pa dokumentet përkatëse;
- ndërsa një numër i konsiderueshëm institucioneve e mban regjistrin të paplotë, të paaktualizuar ose me të dhëna të pjesshme.

Për publikun, kjo do të thotë se, edhe pse regjistri ekziston, ai shpesh nuk shërben si një mjet real transparence. Në shumë raste, qytetarët përballen me lista të thjeshta kërkesash pa përmbajtje, ose me informacione të kufizuara që nuk lejojnë kuptimin e plotë të përgjigjeve të dhëna nga institucionet.

Në këtë kuptim, problemi ka kaluar nga faza e mungesës së regjistrit në fazën e formalizimit të tij. Një regjistër që ekziston vetëm si strukturë, por nuk përmban informacion të plotë dhe të aksesueshëm, nuk arrin të përmbushë funksionin për të cilin është krijuar.

Pikërisht për këtë arsye, ndryshimet e vitit 2023 në ligjin nr. 119/2014 vendosën një standard më të qartë, duke detyruar që regjistri të përditësohet së paku një herë në muaj dhe të ofrojë akses mbi dokumentet e dhëna. Megjithatë, edhe për vitin 2025, këto detyrime nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë. Shumica e institucioneve vijojnë të publikojnë të dhëna të pjesshme, ndërsa vetëm një pjesë shumë e kufizuar e institucioneve përmbushin standardin e plotë të transparencës. Konkretisht, vetëm 13% e autoriteteve publike disponojnë një regjistër të plotë dhe të rifreskuar në përputhje me kërkesat ligjore. Brenda kësaj përqindjeje, spikat kategoria e autoriteteve kushtetuese dhe të pavarura, ku rreth 30% e tyre ofrojnë regjistra funksionalë dhe të përditësuar, ndërsa në sektorin e drejtësisë ky nivel zbret në 10%. Autoritetet e pushtetit ekzekutiv, si në nivel qendror ashtu edhe në atë të varësisë, paraqiten në nivele edhe më të ulëta të përmbushjes cilësore. Veçanërisht problematike mbetet situata në pushtetin vendor, ku nuk konstatohet asnjë autoritet që të ketë një regjistër të plotë sipas standardeve të kërkuara. Ky fakt është veçanërisht shqetësues, duke pasur parasysh se pushteti vendor është shpesh institucioni më i afërt me qytetarin, sidomos në qytetet jashtë Tiranës, ku në shumë raste bashkia përbën autoritetin kryesor, dhe shpesh të vetëm, për ndërveprim të drejtpërdrejtë me publikun.

Pra, megjithëse progresi sasior është i dukshëm, nga një mungesë pothuajse totale e regjistrit në vitet e para në vetëm 7% të institucioneve pa regjistër në vitin 2025, progresi cilësor mbetet i kufizuar. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të transparencës proaktive, duke reflektuar hendekun midis përmbushjes formale dhe transparencës reale në administratën publike.

c) Koordinatorët për të drejtën e informimit

Ligji nr. 119/2014 i ka dhënë një rëndësi të posaçme rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i cili duhet të shërbejë si pikë unike kontakti mes qytetarëve dhe institucionit publik. Koordinatorët janë përgjegjës për menaxhimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, për ndihmën ndaj qytetarëve në formulimin e kërkesave dhe për garantimin e respektimit të afateve ligjore.

Monitorimet e viteve të para pas hyrjes në fuqi të ligjit treguan mangësi të theksuara në këtë drejtim, ku një pjesë e konsiderueshme e institucioneve nuk kishin caktuar koordinatorë ose nuk kishin bërë publik identitetin dhe kontaktet e tyre. Pas vitit 2017, ky tregues filloi të përmirësohej, kryesisht si rezultat i presionit publik dhe ndërhyrjeve të Komisionerit, i cili e ka konsideruar vazhdimisht këtë detyrim si një nga elementët bazë të zbatimit të ligjit.

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë një përmirësim të dukshëm në aspektin formal, ku 98% e autoriteteve publike rezultojnë të kenë caktuar koordinator për të drejtën e informimit, ndërsa vetëm 2% nuk kanë një të tillë ose nuk e kanë bërë publik këtë informacion. Ky është një nga treguesit më të mirë të përmbushjes në kuadër të transparencës proaktive dhe tregon se ky detyrim është tashmë i institucionalizuar në shumicën dërrmuese të institucioneve.

Megjithatë, përmirësimi në nivel formal nuk përkthehet domosdoshmërisht në efektivitet real. Edhe pse koordinatorët janë të caktuar pothuajse në të gjitha institucionet, mbetet e paqartë në shumë raste se si ata e ushtrojnë funksionin e tyre në praktikë. Një pjesë e administratës publike vijon ta trajtojë këtë funksion më tepër si një kërkesë formale sesa si një mekanizëm aktiv për lehtësimin e aksesit në informacion.

Edhe pse problemi i mungesës së koordinatorëve është në masë të madhe i tejkaluar, sfida kryesore mbetet funksionalizimi i këtij roli. Për të arritur këtë, është e nevojshme që Komisioneri të fokusohet më shumë në cilësinë e ushtrimit të funksionit dhe jo vetëm në ekzistencën e tij, duke përdorur në mënyrë më aktive instrumentet e mbikëqyrjes dhe, kur është e nevojshme, edhe sanksionet administrative. Vetëm në këtë mënyrë, koordinatorët mund të marrin realisht rolin që ligji u ka dhënë si garantë të parë të transparencës në institucionet publike.

4.2 Sjellja e institucioneve ndaj kërkesave për informacion

Res Publica ndër vite ka monitoruar dhe testuar në mënyrë të vazhdueshme sjelljen e autoriteteve publike ndaj kërkesave për informacion, si komponenti kryesor i transparencës reaktive. Ndryshe nga transparenca proaktive, e cila varet nga iniciativa e vetë institucioneve, transparenca reaktive vendos autoritetet publike përballë një detyrimi të drejtpërdrejtë për të dhënë informacion mbi çështje konkrete, shpesh me interes të lartë publik.

Elementet e monitoruar në këtë kontekst lidhen me mënyrën e reagimit të institucioneve ndaj kërkesave për informacion, duke përfshirë dhënien ose refuzimin e informacionit, respektimin e afateve ligjore, si dhe sjelljen e institucioneve në fazën pasuese të ankimit administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Për të garantuar një analizë të qendrueshme dhe të krahasueshme ndër vite, edhe për vitin 2025 është përdorur i njëjti kampion prej 200 kërkesash për informacion, të adresuara ndaj autoriteteve publike të kategorive të ndryshme, duke ruajtur metodologjinë e pandryshuar të ndjekur që prej fillimit të monitorimit.

Në mënyrë të përmbledhur, janë monitoruar komponentët e mëposhtëm:

- Sasia dhe cilësia e përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare
- Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ te Komisioneri
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas depozitimit të ankimit administrativ

a) Fusha e informacionit të kërkuar

Kërkesat për informacion të adresuara gjatë vitit 2025 kanë përfshirë një gamë të gjerë fushash, duke synuar jo vetëm testimin e transparencës në çështje rutinë administrative, por edhe në fusha që lidhen me informacion sensitive apo me interes të lartë publik, për të cilat autoritetet publike shpesh shfaqin rezistencë në publikim.


Në këtë kuadër, janë kërkuar informacione në fusha të tilla si:

- Mjedisi
- Ekonomi
- Ndërtimi
- Energjia
- Drejtësia
- Shëndetësia
- Prokurime publike
- Kulturë, etj

Kjo shpërndarje e tematikave ka mundësuar një vlerësim më të plotë të sjelljes së institucioneve, duke testuar reagimin e tyre në rastet kur informacioni i kërkuar ka ndikim të drejtpërdrejtë në interesin publik.

b) Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare

Fig. 7 - Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare



Këto të dhëna tregojnë një përmirësim të moderuar krahasuar me vitin pararendës në aspektin e përgjigjeve të plota dhe një rënie të ndjeshme të mospërgjigjeve, çka sugjeron një reagim më të shpejtë dhe më të detyruar të institucioneve ndaj kërkesave për informacion. Megjithatë, analiza më e thelluar tregon se ky përmirësim mbetet i pjesshëm dhe jo i konsoliduar.

Fakti që mbi një të tretën e rasteve (35%) nuk rezultojnë në një përgjigje të plotë, duke përfshirë përgjigjet e pjesshme dhe mospërgjigjet, tregon se transparenca reaktive vijon të jetë një sfidë strukturore. Në veçanti, përqindja e përgjigjeve të pjesshme (16%) sugjeron një prirje të institucioneve për të dhënë informacion selektiv, duke shmangur shpesh elementët më të ndjeshëm ose me interes të lartë publik.


Nga ana tjetër, edhe pse mospërgjigjet janë ulur në krahasim me vitet e mëparshme, niveli prej 19% mbetet i lartë për një sistem që ka më shumë se një dekadë në funksionim. Mospërgjigja përbën formën më të qartë të shkeljes së ligjit, pasi nuk i jep qytetarit asnjë informacion dhe asnjë mundësi për të kuptuar arsyet e refuzimit.

Në këtë kuptim, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se institucionet kanë bërë hapa drejt rritjes së përgjigjeve, por transparenca reaktive vijon të karakterizohet nga një sjellje selektive dhe jo e qëndrueshme. Përmirësimi nuk është ende rezultat i një kulture të brendshme transparence, por më tepër i presionit të vazhdueshëm institucional dhe publik për respektimin e ligjit.

c) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” sanksionon detyrimin e autoriteteve publike për t’iu përgjigjur kërkesave për informacion brenda një afati prej 10 ditësh pune, me mundësinë e shtyrjes vetëm në raste të veçanta dhe të justifikuara. Ky afat synon të garantojë që informacioni i kërkuar të jetë ende aktual dhe i përdorshëm për qytetarët, gazetarët dhe aktorët e shoqërisë civile.

Fig. 8 - Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare



Të dhënat e vitit 2025 tregojnë një përmirësim të moderuar sa i takon kohëzgjatjes mesatare të kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare. Nga monitorimi rezulton se përgjigjet janë kthyer mesatarisht brenda 16 ditëve kalendarike, duke reflektuar një situatë më të mirë krahasuar me vitin pararendës dhe duke u afruar me nivelet e vitit 2022.

Megjithatë, pavarësisht këtij përmirësimi, afati ligjor nuk respektohet në mesatare. Duke pasur parasysh se 10 ditë pune korrespondojnë afërsisht me rreth 14 ditë kalendarike, rezultati prej 16 ditësh tregon se institucionet vijnë të tejkalojnë afatet ligjore, edhe në rastet kur japin përgjigje. Kjo nënkupton se përmirësimi është relativ dhe nuk përbën ende një përputhje të plotë me kërkesat e ligjit. Në analizë më të gjerë, kjo situatë tregon dy problematika kryesore:


- së pari, gjatë tre viteve të fundit ekziston një tendencë për përmirësim gradual të shpejtësisë së përgjigjeve, çka sugjeron një reagim të administratës ndaj presionit institucional dhe publik;
- së dyti, mungon ende një respektim i qëndrueshëm i afateve ligjore, duke treguar se menaxhimi i kërkesave për informacion mbetet i ngadalshëm dhe joefikas në shumë institucione.

Në këtë kuptim, edhe pse viti 2025 shënon një hap përpara në krahasim me periudhat më problematike, transparenca reaktive mbetet e kufizuar nga vonesat sistematike, të cilat e zbehin efektivitetin real të së drejtës për informim dhe kufizojnë përdorimin e informacionit në kohë reale.

d) Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ

Nga monitorimi i vazhdueshëm rezultojnë se ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit mbetet një nga mekanizmat kryesorë që detyron institucionet publike të reagojnë ndaj kërkesave për informacion. Në shumë raste, reagimi i institucioneve nuk ndodh në fazën fillestare, por vetëm pas përfshirjes së autoritetit mbikëqyrës.

Fig. 9 - Kthimi i përgjigjeve pas ankimit administrativ



Të dhënat për vitin 2025 tregojnë një përkeqësim të situatës në këtë drejtim. Koncretisht, në 22% të rasteve, institucionet nuk kanë kthyer përgjigje as pas dorëzimit të ankimit administrativ, duke shënuar një regres krahasuar me vitin pararendës dhe duke e rikthyer situatën në nivele të ngjashme me vitet 2022–2023.

Ky tregues është veçanërisht shqetësues, pasi ankimi administrativ përfaqëson fazën e dytë dhe më të fortë të detyrimit ligjor për autoritetet publike. Mosreagimi edhe në këtë fazë tregon një nivel të lartë të rezistencës institucionale dhe dobësi në efektivitetin e mekanizmave të zbatimit të ligjit.

Nga ana tjetër, fakti që shumë autoritete reagojnë pas ankimit konfirmon se ky mekanizëm vazhdon të jetë funksional dhe i domosdoshëm. Megjithatë, variabiliteti i këtij treguesi ndër vite dhe rikthimi i tij në nivele më problematike në vitin 2025 sugjerojnë mungesë konsistence në sjelljen e institucioneve dhe varësi të fortë nga presioni i jashtëm.

Në këtë kuptim, të dhënat tregojnë se transparenca reaktive në Shqipëri mbetet në thelb një proces i kushtëzuar nga ndërhyrja e Komisionerit. Në vend që reagimi të jetë një praktikë standarde e administratës, ai shpesh aktivizohet vetëm pas ankimit, ndërsa në një pjesë të rasteve nuk ndodh as në këtë fazë.


Kjo situatë thekson nevojën për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të zbatimit, veçanërisht në drejtim të detyrimit për reagim pas ankimit dhe aplikimit më të shpeshtë të sanksioneve në rastet e moszbatimit. Vetëm në këtë mënyrë ankimi administrativ mund të shërbejë jo vetëm si mjet korrigjues, por edhe si instrument parandalues ndaj shkeljeve të ligjit.

e) Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ

Pas paraqitjes së një ankimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, është bërë tashmë një praktikë e zakonshme që institucionet të vihen në lëvizje dhe të japin informacionin e kërkuar. Në shumë raste, reagimi që mungon në fazën fillestare aktivizohet vetëm pas përfshirjes së këtij mekanizmi mbikëqyrës, çka konfirmon rolin e tij thelbësor në funksionimin e transparencës reaktive.

Duhet theksuar gjithashtu se një pjesë e konsiderueshme e ankimeve zgjidhen përmes ndërmjetësimit të Komisionerit, pa arritur në një vendimmarrje formale, çka ndikon drejtpërdrejt në shpejtësinë e reagimit të institucioneve.

Fig. 10 - Kohëzgjatja e përgjigjes pas ankimit administrativ



Të dhënat për vitin 2025 tregojnë një përmirësim të ndjeshëm në këtë drejtim. Kohëzgjatja mesatare e reagimit të institucioneve pas ankimit rezultoi 12 ditë kalendarike, duke përbërë nivelin më të ulët të regjistruar në dhjetë vitet e fundit. Ky rezultat tregon një rritje të efektivitetit të ankimit administrativ si instrument korrigjues dhe një reagim më të shpejtë të institucioneve në këtë fazë të procesit.


Megjithatë, ky përmirësim duhet analizuar në mënyrë të balancuar. Nga njëra anë, ai sugjeron se institucionet reagojnë më shpejt kur përfshihet Komisioneri dhe kur rritet presioni institucional për zbatimin e ligjit. Nga ana tjetër, fakti që reagimi i shpejtë ndodh kryesisht pas ankimit dhe jo që në fazën fillestare tregon se transparenca vijon të jetë reaktive dhe e kushtëzuar, dhe jo një praktikë e brendësuar e administratës.

Përmirësimi i vitit 2025 mund të lidhet edhe me ndryshimet ligjore të viteve të fundit, të cilat kanë forcuar mekanizmat e sanksionimit ndaj personave përgjegjës për pengimin e dhënies së informacionit. Rritja e rrezikut të ndëshkimit duket se ka ndikuar në përshpejtimin e reagimit institucional në fazën e ankimit.

Në këtë kuptim, edhe pse të dhënat tregojnë një progres në shpejtësinë e reagimit pas ankimit, ato konfirmojnë njëkohësisht se sistemi vazhdon të funksionojë më mirë nën presion sesa në mënyrë spontane. Transparenca reaktive mbetet ende e varur nga ndërhyrja e Komisionerit, duke e bërë ankimin jo vetëm një mekanizëm korrigjues, por një hap pothuajse të domosdoshëm për sigurimin e informacionit në praktikë.

f) Vlerësim agregat

Fig. 11 - Vlerësim agregat i reagimit ndaj kërkesave për informacion



Analiza e agreguar e të dhënave për vitin 2025 ofron një panoramë më të plotë të mënyrës se si funksionon në praktikë sistemi i aksesit në informacion. Të dhënat tregojnë një shpërndarje të qartë të kohëzgjatjes dhe mënyrës së reagimit të institucioneve, duke reflektuar diferencat midis rasteve që trajtohen në mënyrë rutinë dhe atyre që kërkojnë ndërhyrje shtesë.

Të dhënat tregojnë se, në shumicën e rasteve, institucionet reagojnë brenda një afati relativisht të pranueshëm, edhe pse ende mbi standardin ligjor. Megjithatë, ekziston një pjesë e konsiderueshme e kërkesave që trajtohen me vonesë të ndjeshme, duke treguar se menaxhimi i kërkesave për informacion mbetet i pabarabartë dhe jo i standardizuar.

Veçanërisht domethënëse është struktura e rasteve që kërkojnë ankimin administrativ apo ndërhyrjen e gjykatës. Edhe pse këto përbëjnë një përqindje të vogël në aspekt numerik, ato zakonisht lidhen me informacione me interes të lartë publik, si kontratat koncesionare, prokurimet apo vendimmarrje me ndikim të drejtpërdrejtë në interesin publik. Kjo tregon se sistemi funksionon më mirë në rastet rutinë, por has rezistencë në rastet më të ndjeshme.

Në këtë kuptim, edhe pse statistikat e përgjithshme mund të krijojnë përshtypjen e një sistemi relativisht funksional, analiza e thelluar tregon një realitet më kompleks. Transparenca nuk është e njëtrajtshme. Ajo funksionon në një pjesë të rasteve, ndërsa në një pjesë tjetër kërkon ndërhyrje shtesë dhe shpesh zgjatje të konsiderueshme në kohë deri në humbjen e vlerës së informacionit.

IV. KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i atribuon Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale rolin qendror në garantimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Si autoritet i pavarur, Komisioneri përbën mekanizmin kryesor institucional që ndërhyt në rastet kur autoritetet publike nuk përmbushin detyrimet e tyre për transparencë.

Kompetencat e Komisionerit janë forcuar më tej me ndryshimet ligjore të vitit 2023, të cilat synojnë rritjen e efektivitetit të këtij institucioni në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe ndëshkuese. Në këtë kuadër, Komisioneri ka sot një rol më aktiv në vendosjen e masave administrative dhe në ndëshkimin e shkeljeve që lidhen me moszbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Në praktikë, veprimtaria e Komisionerit zhvillohet në dy drejtime kryesore. Së pari, përmes monitorimit të transparencës proaktive të institucioneve publike, duke vlerësuar publikimin dhe përditësimin e programeve të transparencës, funksionimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe caktimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit. Së dyti, përmes trajtimit të ankesave të paraqitura nga qytetarët, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile në rastet e refuzimit, vonesës apo dhënies së pjesshme të informacionit.

Që prej krijimit të këtij institucioni në vitin 2014, Res Publica ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e Komisionerit, duke analizuar rolin dhe efektivitetin e tij në garantimin e të drejtës për informim. Kjo analizë bazohet si në të dhënat zyrtare të siguruar nga vetë institucioni.

Në këtë kapitull paraqitet një analizë e përmbledhur e zhvillimeve kryesore për vitin 2025, e vendosur në një kontekst krahasimor me vitet e mëparshme. Analiza fokusohet në indikatorët kryesorë të funksionimit të Komisionerit, përfshirë numrin e ankesave të paraqitura, kategorinë e subjekteve ankues, numrin dhe llojin e vendimeve të marra, kohëzgjatjen e trajtimit të tyre, si dhe aplikimin e sanksioneve administrative.

4.1 Rezoluta e Kuvendit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si çdo vit, ka paraqitur raportin e tij në Kuvend, proces i cili është finalizuar me miratimin e Rezolutës për vitin 2024, më 09.10.2025. Ky dokument, në thelb, paraqet një vlerësim pozitiv të veprimtarisë së institucionit, duke theksuar rolin e tij në monitorimin e transparencës, trajtimin e ankesave dhe zhvillimet në kuadrin ligjor.

Megjithatë, një analizë më e thelluar e përmbajtjes së rezolutës nxjerr në pah një problem themelor: mungesën pothuajse të plotë të fokusit mbi të drejtën e informimit dhe transparencën e autoriteteve publike. Rekomandimet e Kuvendit janë përqendruar kryesisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke lënë në plan të dytë komponentin e aksesit në informacion, i cili përbën një nga instrumentet kryesore të kontrollit demokratik. Kjo mungesë është veçanërisht problematike në një kontekst ku shoqëria civile dhe gazetarët vazhdojnë të hasin vështirësi reale në aksesin në informacion, veçanërisht në rastet që lidhen me çështje sensitive ose me interes të lartë publik. Siç evidentohet edhe në këtë raport, pikërisht këto raste përbëjnë një përqindje të vogël, por kritike, ku informacioni nuk jepet lehtësisht ose refuzohet plotësisht. Në këtë kuptim, rezoluta nuk adreson problematikën reale të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke e anashkaluar dimensionin më thelbësor të tij.

Problematika nuk lidhet vetëm me përmbajtjen, por edhe me vetë procesin e miratimit të rezolutës. Nga analiza e këtij procesi, rezulton se ai ka qenë kryesisht formal, pa një debat publik dhe pa përfshirjen e aktorëve kryesorë të interesit, si organizatat e shoqërisë civile apo komuniteti i gazetarëve, të cilët janë përdoruesit më aktivë të këtij ligji. Mungesa e një procesi konsultativ reflektohet drejtpërdrejt në cilësinë e produktit final, duke e bërë rezolutën një dokument më tepër deklarativ sesa orientues.

Në këtë kontekst, rezoluta krijon përshtypjen e një qasjeje institucionale minimale, sa për të përmbushur detyrimin formal, pa një analizë reale të sfidave dhe pa një drejtim të qartë për përmirësimin e situatës. Kjo është edhe më e dukshme kur krahasohet me dinamika të tjera parlamentare, ku çështje të caktuara, si emërimet në institucione të tjera kushtetuese, kanë gjeneruar debat të gjerë politik, ndërkohë që roli i Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili është kyç për kontrollin demokratik dhe transparencën, mbetet jashtë vëmendjes së nevojshme.

Një tjetër element problematik lidhet me mënyrën se si Komisioneri vetë raporton për zbatimin e kësaj rezolute. Në raportin vjetor për vitin 2025, institucioni deklaroi se rekomandimet e Kuvendit janë përmbushur plotësisht, kryesisht përmes miratimit të akteve nënligjore, zhvillimit të trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuëse. Megjithatë, rezoluta për vitin 2024 nuk arrin të përmbushë funksionin e saj si instrument mbikëqyrës dhe orientues për përmirësimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Ajo reflekton një mungesë prioritizimi të kësaj të drejte në nivel politik dhe institucional, duke lënë pa adresuar një nga fushat më kritike për funksionimin e demokracisë dhe llogaridhënies publike në vend.

4.2. Statistika nga veprimtaria e Komisionerit për vitin 2025

a) Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

Për vitin 2025, numri i ankesave të drejtuara pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit rezulton 861 ankesa të reja, duke shënuar një rënie të lehtë dhe duke vijuar trendin rënës të katër viteve të fundit.

Fig. 12 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit



Analiza në perspektivë kohore tregon se, duke filluar nga viti 2017 deri 2019, numri i ankesave ka ndjekur një trend rritës pothuajse të pandërprerë, duke reflektuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe përdorimin më aktiv të këtij mekanizmi nga qytetarët, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Përrjashtim nga ky trend përbën viti 2020, i cili përkon me periudhën e pandemisë dhe kufizimeve të funksionimit të institucioneve publike, çka ndikoi drejtpërdrejt në uljen e numrit të kërkesave dhe, rrjedhimisht, edhe të ankesave.

Që nga viti 2022 trendi është në rënie dhe kërkon një interpretim më të thelluar. Kjo rënie nuk mund të konsiderohet automatikisht si tregues pozitiv i përmirësimit të transparencës.

Një nga shpjegimet e mundshme lidhet me dekurajimin gradual të qytetarëve dhe gazetarëve, të cilët përballen me procese të gjata dhe shpesh joefikase për sigurimin e informacionit në rastet sensitive. Siç evidentohet edhe në këtë raport, në shumë raste marrja e informacionit kërkon kalimin në fazën e ankimit dhe shpesh zgjat përtej afateve që e bëjnë atë të përdorshëm në kohë reale. Në këto kushte, informacioni humbet vlerën e tij praktike të shpejtë, duke reduktuar motivimin për të ndjekur procedurat deri në fund.


Nga ana tjetër, ky trend mund të lidhet edhe me ndryshimet më të gjera në mënyrën se si funksionon hapësira mediatike dhe interesi publik ndaj informacionit. Vërehet një zhvendosje e vëmendjes nga investigimi i thelluar dhe zbulimi i fakteve drejt një modeli më të fragmentuar dhe shpesh më sipërfaqësor të konsumit të informacionit, ku rritet interesi për përmbajtje sensacionale apo “skandalistike”, ndërsa kërkesa për informacion të strukturuar dhe të dokumentuar mbetet më e kufizuar.

Në këtë kontekst, rënia e ankesave nuk duhet parë domosdoshmërisht si një tregues i përmirësimit të sistemit, por mund të reflektojë edhe një dobësim të përdorimit efektiv të së drejtës për informim si mjet kontrolli demokratik. Nëse kjo tendencë vijon, ekziston rreziku që ligji të humbasë gradualisht funksionin e tij si instrument për nxjerrjen në dritë të informacionit me interes publik, duke u zëvendësuar nga forma më të shpejta, por më pak të qëndrueshme të prodhimit të informacionit.

b) Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

Nga 861 ankesa të adresuara pranë Komisionerit gjatë vitit 2025, rezulton se 55% e ankesave janë paraqitur nga gazetarë dhe aktivistë, ndërsa 45% nga qytetarë.

Fig. 13 - Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit



Në pamje të parë, kjo shpërndarje konfirmon se gazetarët dhe aktivistët vijojnë të jenë përdoruesit kryesorë të mekanizmit të ankimit. Megjithatë, analiza në kohë zbulon një ndryshim të rëndësishëm strukturor. Që prej vitit 2021 vihet re një rritje e qëndrueshme e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe njëkohësisht një rënie e pjesëmarrjes së gazetarëve dhe aktivistëve.

Ky zhvillim bëhet edhe më domethënës kur lidhet me trendin e përgjithshëm të rënies së numrit total të ankesave në vitet e fundit. Duke qenë se numri total i ankesave është në rënie, ndërsa pesha e qytetarëve është në rritje, rezulton se niveli i angazhimit të qytetarëve ka mbetur relativisht i qëndrueshëm. Në të kundërt, rënia e përgjithshme e ankesave duket se është shkaktuar kryesisht nga tkurrja e interesit dhe aktivizimit të gazetarëve dhe aktivistëve.

Kjo prirje përkon me analizën e bërë më sipër për numrin total të ankesave dhe mund të lidhet me disa faktorë strukturorë. Së pari, procesi i gjatë dhe shpesh joefikas për marrjen e informacionit, që kalon nga kërkesa fillestare të ankimit dhe, në disa raste, edhe të gjykata, e bën këtë instrument më pak funksional për punën investigative, ku koha është faktor kyç. Në këto kushte, informacioni i marrë me vonesë shpesh humbet vlerën e tij për publikim.

Së dyti, ndryshimet në dinamikën e medias dhe konsumit të informacionit kanë ndikuar në zhvendosjen e vëmendjes nga investigimi i thelluar drejt formave më të shpejta dhe më sipërfaqësore të prodhimit të lajmit. Kjo ka reduktuar përdorimin e mekanizmave formalë të transparencës, si kërkesat për informacion dhe ankimi administrativ.

Në këtë kontekst, rritja relative e qytetarëve nuk kompenson rënien e gazetarëve dhe aktivistëve, të cilët tradicionalisht kanë qenë përdoruesit më aktivë dhe më efektivë të këtij ligji. Për rrjedhojë, kjo tendencë sugjeron jo vetëm një ndryshim në profilin e përdoruesve të ligjit, por edhe një dobësim të rolit të tij si instrument për kontroll publik dhe investigim.


c) Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

Referuar monitorimit të faqes zyrtare të Komisionerit, si dhe të dhënave zyrtare të siguruar, rezulton se për vitin 2025 janë marrë 33 vendime.

Në një lexim të parë, kjo shifër përfaqëson një rritje krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, analiza në perspektivë më të gjerë kohore tregon se trendi i vendimmarrjes mbetet në

përgjithësi rënës që prej vitit 2022, me përjashtim të një rritjeje të përkohshme gjatë vitit 2024. Kjo do të thotë se niveli aktual i vendimmarrjes nuk përfaqëson një përmirësim të qëndrueshëm, por më tepër një luhajtje brenda një tendence në rënie.

Fig. 14 - Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri



Për më tepër, pavarësisht ndryshimeve ndër vite, numri i vendimeve mbetet i ulët në terma absolutë, veçanërisht në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave të paraqitura. Nga qindra ankesa të trajtuara çdo vit, vetëm një pjesë shumë e kufizuar përfundojnë me një vendim formal të Komisionerit.

Kjo tregon se vendimmarrja mbetet një mekanizëm i përdorur në mënyrë të kufizuar, ndërsa pjesa më e madhe e rasteve trajtohet përmes ndërmjetësimit ose mbetet pa një akt përfundimtar të arsyetuar. Edhe pse ndërmjetësimi mund të shërbejë si një mjet praktik për zgjidhjen e shpejtë të rasteve, përdorimi i kufizuar i vendimeve formale, dhe zgjerimi i ndërmjetësimit, pa verifikuar rezultatin real të tij, krijon rrezikun që raste të pazgjdhura të raportohen si të mbyllura, duke dobësuar transparencën dhe besueshmërinë e mekanizmit.

Së pari, mungon krijimi i një praktike të qëndrueshme administrative, e cila do të ndihmonte në unifikimin e interpretimit të ligjit nga autoritetet publike. Së dyti, kufizohet transparenca dhe parashikueshmëria e procesit, pasi mungojnë vendime të arsyetuara që mund të shërbejnë si referencë për rastet e ardhshme.

Së treti, dhe më e rëndësishmja në kontekstin aktual, ndryshimet ligjore të vitit 2023 kanë lidhur drejtpërdrejt moszbatimin e vendimeve të Komisionerit me aplikimin e sanksioneve administrative (gjobave). Në këtë kuptim, numri i ulët i vendimeve prodhon një efekt të drejtpërdrejtë zinxhir: sa më pak vendime të merren, aq më i ulët është edhe potenciali për të aplikuar sanksione ndaj institucioneve që shkelin ligjin.


Kjo krijon një dobësim të mekanizmit të zbatimit, pasi mungesa e vendimeve redukton jo vetëm ndëshkimin konkret, por edhe efektin parandalues që duhet të ketë ligji. Në praktikë, kjo mund të përkthehet në një nivel më të ulët presioni ndaj institucioneve për të respektuar detyrimet e tyre për transparencë.

Në këtë kuptim, të dhënat e vitit 2025 konfirmojnë se, pavarësisht luhajtjeve të përkohshme, vendimmarrja e Komisionerit mbetet në nivele të ulëta dhe nuk përbën ende mekanizmin kryesor të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke kufizuar edhe efektivitetin e instrumenteve ndëshkuese të parashikuara nga ligji.

d) Llojet e vendimeve

Neni 24 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon se Komisioneri për të Drejtën e Informimit, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, mund të vendosë për: (1) mospranimin e ankesës, (2) pranimin e saj dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, ose (3) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht. Në rastet e pranimit të ankesës, Komisioneri mund të vendosë edhe masa administrative, përfshirë sanksionet me gjobë ndaj personave përgjegjës.

Fig. 15 - Llojet e vendimeve



Për vitin 2025, 61% e vendimeve janë me pranim të plotë të ankesës, 6% janë me pranim të pjesshëm, ndërsa 33% janë vendime rrëzimi.

Shumica e vendimeve mbeten në favor të kërkuarve të informacionit, duke treguar se në një pjesë të konsiderueshme të rasteve Komisioneri konstaton shkelje të ligjit nga ana e autoriteteve publike. Megjithatë, një element i rëndësishëm që vihet re në vitin 2025 është vijimi i rritjes së vendimeve të rrëzimit, të cilat arrijnë në 33% dhe përbëjnë nivelin më të lartë të regjistruar gjatë dhjetë viteve të fundit.

Ky zhvillim ngre disa çështje për interpretim. Nga njëra anë, mund të lidhet me një përzgjedhje më të kujdesshme të rasteve nga ana e Komisionerit ose me një rritje të numrit të ankesave që bien jashtë fushës së ligjit. Nga ana tjetër, rritja e vendimeve të rrëzimit mund të reflektojë edhe një qasje më restriktive në interpretimin e të drejtës për informim, veçanërisht në rastet që lidhen me informacion më të ndjeshëm ose me kufizime ligjore.


Në çdo rast, kjo prirje duhet parë në kontekstin më të gjerë të funksionimit të sistemit. Duke qenë se numri total i vendimeve mbetet i ulët, çdo ndryshim në strukturën e tyre ka një peshë të konsiderueshme në analizë. Rritja e vendimeve të rrëzimit, e kombinuar me numrin e kufizuar të vendimeve në përgjithësi, sugjeron se aksesimi i informacionit përmes këtij mekanizmi mbetet i pasigurt dhe jo plotësisht i parashikueshëm.

Në këtë kuptim, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se, edhe pse Komisioneri vijon të luajë një rol të rëndësishëm në korrigjimin e shkeljeve, struktura e vendimmarrjes po bëhet më e balancuar në mënyrë formale, por jo domosdoshmërisht më e favorshme për garantimin e plotë të së drejtës për informim në praktikë.

e) Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri ka detyrimin të shprehet me vendim brenda një afati prej 15 ditësh pune nga momenti i paraqitjes së ankimit. Ky afat synon të garantojë një mekanizëm efektiv dhe të shpejtë korrigjimi, duke siguruar që e drejta për informim të mos humbasë vlerën e saj për shkak të vonesave procedurale.

Fig. 16 - Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri



Nga 33 vendime të marra gjatë vitit 2025, rezulton se vetëm 30% e tyre janë dhënë brenda afatit ligjor, ndërsa në 70% të rasteve ky afat është tejkaluar. Kjo tregon një nivel të ulët respektimi të detyrimeve kohore nga ana e vetë institucionit që ka për detyrë të garantojë zbatimin e ligjit.

Në një analizë krahasuese me reagimin e institucioneve ndaj kërkesave fillestare për informacion, vihet re një kontrast i qartë. Ndërsa institucionet publike kanë shfaqur një përmirësim të lehtë në kohëzgjatjen e kthimit të përgjigjeve, vetë Komisioneri paraqet një regres në respektimin e afateve për marrjen e vendimeve.

Ky zhvillim është veçanërisht problematik për dy arsye:


- Së pari, vonesat në vendimmarrje e zbehin funksionin korrigjues të ankimit administrativ, pasi informacioni i kërkuar shpesh humbet aktualitetin dhe rëndësinë e tij praktike.
- Së dyti, ai dëmton besimin në mekanizmin mbikëqyrës, duke krijuar perceptimin se edhe në nivelin e dytë të shqyrtimit, procesi mbetet i ngadaltë dhe joefikas nëse informacioni i kërkuar rrezikon të humbasë shpejt aktualitetin.

Në këtë kuptim, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se problemi i vonesave nuk është i kufizuar vetëm në nivelin e autoriteteve publike, por shtrihet edhe në nivelin e institucionit mbikëqyrës. Kjo krijon një efekt zinxhir, ku vonesat në çdo hallkë të procesit e bëjnë ushtrimin e së drejtës për informim më të vështirë dhe më pak efektiv.

Në përfundim, pavarësisht rolit kyç të Komisionerit në garantimin e transparencës, mosrespektimi i afateve ligjore për marrjen e vendimeve mbetet një nga dobësitë kryesore të sistemit, duke kufizuar ndjeshëm efektivitetin e mekanizmit të ankimit si instrument mbrojtës për qytetarët.

f) Aplikimi i sanksioneve

Fig. 17 - Aplikimi i sanksioneve nga Komisioneri



Për vitin 2025 vihet re sërish një numër i kufizuar i sanksioneve administrative (gjobave) të vendosura nga Komisioneri në kuadër të trajtimit të ankesave për refuzim të dhënies së informacionit, të cilat rezultojnë vetëm në 2 raste. Ky tregues është negativ, veçanërisht në kontekstin e ndryshimeve ligjore të vitit 2023 që synonin forcimin e mekanizmave ndëshkues për moszbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Ky zhvillim bëhet edhe më i rëndësishëm kur analizohet në raport me treguesit e tjerë. Pavarësisht rritjes së numrit të vendimeve të marra gjatë vitit 2025, përdorimi i sanksioneve në rastet e refuzimi të dhënies së informacionit mbetet minimal. Kjo tregon se vendimmarrja nuk po shoqërohet me masa ndëshkuese në rastet e rëndësishme për publikun.

Në të njëjtën kohë, vihet re një përdorim më i gjerë i sanksioneve në një dimension tjetër të transparencës, atë të përmbushjes së detyrimeve për programet e transparencës. Gjatë vitit 2025 janë vendosur 13 gjoba për mosplotësim ose mos përditësim të këtyre programeve. Megjithatë, shpërndarja e këtyre sanksioneve është e përqendruar në mënyrë disproporcionale në një kategori të caktuar institucionesh, ku 10 prej tyre janë ndërmarrje të ujës-jellës-kanalizimeve në nivel vendor. Kjo tregon se instrumenti i gjobave është përdorur kryesisht për të adresuar sjellje neglizhuese në këtë sektor specifik, dhe jo në mënyrë të gjerë ndaj të gjithë autoriteteve publike që rezultojnë në shkelje.

Pavarësisht këtij përdorimi selektiv, efekti i sanksioneve në këtë fushë duket të jetë më i prekshëm. Që prej vitit 2021, kur Komisioneri nisi të aplikojë më sistematikisht gjoba për mosrespektim të programeve të transparencës, është konstatuar një përmirësim gradual dhe i qëndrueshëm në këtë tregues. Kjo sugjeron se sanksionet, kur përdoren në mënyrë të qëndrueshme, kanë një efekt të qartë disiplinues mbi institucionet.

Megjithatë, kontrasti midis përdorimit më aktiv të gjobave për transparencën proaktive dhe përdorimit shumë të kufizuar të tyre në rastet e refuzimit të informacionit është domethënëse. Ndërkohë që shkeljet formale (si mosplotësimi i programeve) ndëshkohen më shpesh, shkeljet substanciale që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në informacion vijojnë të mbeten në masë të madhe pa pasoja.

Një nga arsyt kryesore për këtë dukuri lidhet me mënyrën e funksionimit të mekanizmit vendimmarrës. Duke qenë se aplikimi i sanksioneve është i lidhur drejtpërdrejt me konstatimin e shkeljes përmes një vendimi, përdorimi i kufizuar i vendimeve dhe orientimi drejt ndërmjetësimit redukton ndjeshëm hapësirën për ndëshkim, në rastet e ankesave për refuzim.

Për më tepër, ky zhvillim bie në kontrast me frymën e ndryshimeve ligjore të vitit 2023, të cilat synonin forcimin e përgjegjësisë së autoriteteve publike dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmave ndëshkues. Në praktikë, përdorimi selektiv i sanksioneve krijon një efekt të pjesshëm: ndërsa në disa fusha (si programet e transparencës) vërehet përmirësim, në të tjera (si dhënia reale e informacionit) mungon presioni i nevojshëm për respektimin e ligjit.

Një shqetësim me rëndësi lidhet me mënyrën se si gjykatat administrative kanë trajtuar çështjet që burojnë nga vendimet e Komisionerit. Sipas të dhënave të raportuara nga vetë Komisioneri, gjatë vitit 2025 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka lënë në fuqi thelbin e vendimit urdhërues, pra detyrimin për dhënien e informacionit, por ka shfuqizuar gjobat e vendosura ndaj personave përgjegjës. Në disa raste të tjera, është konsideruar se dhënia e informacionit pas ndërhyrjes së Komisionerit përbën përmbushje të detyrimit ligjor, duke çuar sërish në anulimin e sanksionit.

Kjo praktikë gjyqësore ka pasoja të drejtpërdrejta në efektivitetin e mekanizmit ndëshkues. Edhe pse konstatohet shkelja e ligjit, heqja sistematike e gjobave dobëson ndjeshëm funksionin parandalues të tyre dhe krijon një precedent problematik. Në terma praktikë, kjo mund të nxisë një sjellje oportuniste nga ana e autoriteteve publike, të cilat mund të zgjedhin të mos japin informacionin në afat, duke e shtyrë përgjigjen vetëm pas ndërhyrjes së Komisionerit, pa u përballur me pasoja reale. Në këtë mënyrë, rrezikohet të krijohet një interpretim de facto i ligjit si një detyrim jo i menjëhershëm, por i kushtëzuar nga presioni institucional, duke cenuar thelbin e së drejtës për informim si një e drejtë që duhet të ushtrohet në kohë dhe në mënyrë efektive.

4.3 Krahasimi i të dhënave të monitorimit me raportimet zyrtare të Komisionerit

Analiza krahasimore ndërmjet të dhënave të raportuara nga vetë Zyra e Komisionerit dhe gjetjeve të monitorimit të Res Publica për vitin 2025 evidenton një diferencë të qëndrueshme midis performancës së raportuar dhe funksionimit real të mekanizmave të transparencës.

a) Kërkesat dhe ankesat shfaqin rritje në letër dhe tkurrje në përdorim real

Sipas raportit vjetor të Komisionerit, për vitin 2025 janë trajtuar 13,029 kërkesa për informacion, nga 11,549 në vitin 2024, ndërsa përgjigjet e plota kanë arritur në 11,017 raste. Në të njëjtën linjë, numri i ankesave rezulton 897 (861 të reja), në rënie krahasuar me vitet e mëparshme.

Interpretimi zyrtar e lidh këtë rënie me përmirësimin e transparencës proaktive. Megjithatë, të dhënat e monitorimit sugjerojnë një lexim alternativ:

- vetëm 65% e kërkesave marrin përgjigje të plotë
- 19% mbeten pa përgjigje
- një pjesë e konsiderueshme kërkon ankim administrativ për t'u zgjidhur

Kjo ngre flamurin e parë të kuq:



Ulja e ankesave nuk është domosdoshmërisht tregues i përmirësimit të transparencës, por mund të reflektojë dekurajimin e përdoruesve të pyetjeve sensitive, sidomos gazetarëve dhe aktivistëve, të cilët përballen me procese të gjata dhe joefikase.

Ky interpretim përforcohet edhe nga të dhënat e vetë Komisionerit, ku kërkesat nga gazetarët kanë rënë nga 3129 në 2979, dhe nga shoqëria civile nga 1540 në 1051.

b) Transparenca proaktive shfaq rritje në indeks dhe dobësi në përmbajtje

Indeksi i Komisionerit për autoritetet publike për vitin 2025 paraqet një panoramë pozitive ku 52.5% e autoriteteve publike kanë transparencë të lartë dhe vetëm 0.5% me transparencë minimale. Ndërkohë, për njësitë e pushtetit vendor, vetëm 38% transparencë të lartë dhe 6% transparencë minimale.

Nga ana tjetër, monitorimi i Res Publica tregon se 77% e autoriteteve arrijnë një përmbushje formale të programeve, por kanë dobësi të theksuara në përditësim, informacion mbi vendimmarrjen, transparencë mbi kontratat dhe financat.

Kjo ngre flamurin e dytë të kuq:



Indekset matin kryesisht praninë e informacionit, jo cilësinë dhe përdorshmërinë e tij.

Kjo konfirmohet edhe nga vetë raporti i Komisionerit, ku theksohet nevoja për përmirësim të kapaciteteve dhe mungesë e stafit dhe ndërgjegjësimin institucional.

c) Regjistri i kërkesave ka përhapje e gjerë, por funksionim të dobët

Komisioneri raporton se 348 autoritete kanë publikuar regjistër, ndërsa monitorimi ynë tregon se vetëm 13% të regjistrave janë realisht funksionale dhe në rastin e pushtetit vendor kjo shifër është afër zeros.

Kjo ngre flamurin e tretë të kuq:



Ekzistenca e regjistrat nuk përthehet në funksionalitet real.

d) Vendimmarrja dhe sanksionet mbeten mekanizëm i pazbatuar

Nga raporti i Komisionerit, janë marrë vetëm 33 vendime për vitin 2025 dhe vetëm vetëm 2 sanksione me gjobë, ndërkohë që 525 raste pretendohet të jenë zgjidhur pa vendim.

Ndërkohë, raporti i përgjithshëm ankesa/vendime është shumë i ulët (3.8%) dhe përdorimi i sanksioneve është minimal.

Një shqetësim i veçantë lidhet me mënyrën se si kategorizohen këto rastet e zgjidhura përmes *ndërmjetësimit*. Nga informacionet e mbledhura në terren dhe nga intervistat me gazetarë përdorues të ligjit për të drejtën e informimit, rezulton se një pjesë e këtyre rasteve nuk përbëjnë në të vërtetë zgjidhje efektive. Në disa raste, kërkuesit janë kontaktuar nga zyra e Komisionerit dhe janë ftuar të tërheqin ankesat me arsyetimin se çështja është zgjidhur, ndërkohë që përgjigjet e dhëna nga institucionet kanë qenë të pjesshme, të paqarta ose pa përmbajtje reale. Kjo praktikë krijon një shtrembërim në raportimin institucional, duke rritur artificialisht numrin e rasteve të zgjidhura dhe duke mos reflektuar situatën reale të aksesit në informacion.

Kjo ngre flamurin e katërt të kuq, i cili është i dyfishtë:



Mekanizmi i mbikëqyrjes funksionon më shumë si ndërmjetës sesa si autoritet detyrues. Raportimi në Kuvend paraqet shtrembërime të realitetit, duke ndikuar në prodhimin e një rezolute të mangët.

Problemi thellohet nga ndryshimet ligjore të vitit 2023, ku u miratuan sanksione për moszbatimin e vendimeve, ndërkohë që numri i ulët i vendimeve kufizon automatikisht sanksionimin.

e) Afatet dhe efektiviteti sugjeron vonesa sistematike

Komisioneri raporton se një pjesë e përgjigjeve jepen brenda 3 ditëve (36%).

Ndërkohë, monitorimi ynë tregon se përgjigja ndaj kërkesës fillestare vjen mesatarisht pas 16 ditësh për 65% të rasteeve dhe 12 ditësh të tjera pas ankimit administrativ në ato raste që avancojnë te Komisioneri.

Kjo ngre flamurin e pestë të kuq:



Ndonëse përmirësimi ekziston, ai mbetet jashtë standardeve ligjore në pjesën më të madhe dhe nuk garanton efektivitetin real që kërkon ligji.

f) Problematikat të tjera të identifikuara nga vetë Komisioneri

Raporti i Komisionerit evidenton disa probleme strukturore, si:

- ristrukturime institucionale që shkaktojnë vonesa
- kërkesa komplekse dhe voluminoze
- ndryshim i shpeshtë i koordinatorëve
- përdorim i klauzolave të konfidencialitetit në kontrata
- paqartësi mbi të drejtën e autorit
- përdorim i ligjit për çështje individuale

Këto gjetje konfirmojnë se problemet janë të njohura, por mbeten të paadresuara në mënyrë efektive.

Krahasimi i të dhënave tregon një dualitet të qartë ku:

- në nivel raportimi institucional shfaqet progres, rritje, përmirësim, por
- në nivel zbatimi praktik shfaqet selektivitet, vonesa, formalizëm

Në këtë kuptim, sistemi nuk është në ndonjë krizë, por në një fazë të zgjatur pa transformim real. Transparenca në Shqipëri funksionon për informacion rutinë, ndërkohë që has rezistencë për informacion me interes publik dhe mbetet e varur nga ndërhyrja e Komisionerit në një pjesë të rëndësishme.

V. ASPEKTE TË VEÇANTA TË VITIT 2025

Ky kapitull trajton disa prej zhvillimeve më të rëndësishme të vitit 2025 në fushën e transparencës dhe të së drejtës për informim, duke u fokusuar si në dimensionin institucional, ashtu edhe në atë praktik dhe jurisprudencial. Në këtë kuadër, analizohen nisma dhe procese që lidhen me agjendën e integritetit dhe llogaridhënies publike, përfshirë zhvillimet në nivel politikash dhe diskutimesh publike, roli dhe funksionimi i Agjencisë për Media dhe Informim, si dhe progresi dhe sfidat në zbatimin e politikave për të dhënat e hapura dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Tromsos. Paralelisht, kapitulli ndalet edhe në raste konkrete që kanë kontribuar në zhvillimin e jurisprudencës në këtë fushë, duke evidentuar mënyrën se si praktika gjyqësore dhe administrative po ndikon në interpretimin dhe zbatimin e së drejtës për informim në Shqipëri.

5.1. Ndërthurja midis *Planit të Integritetit* dhe zbatimit të së drejtës për informim

Plani i Integritetit 2022–2025 i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraqet një kornizë normative të ndërtuar mbi parimet e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të risqeve institucionale. Ai identifikon forcimin e transparencës proaktive, përmirësimin e procedurave administrative, funksionimin efektiv të strukturave përgjegjëse dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si objektiva kyç. Në këtë kuptim, Plani synon të krijojë një arkitekturë institucionale që, në teori, duhet të garantojë ushtrimin efektiv të së drejtës për informim.

Megjithatë, gjetjet e raportit tonë për vitin 2025 tregojnë se kjo arkitekturë mbetet kryesisht funksionale në nivel formal, ndërsa në praktikë evidentohet një hendek i qëndrueshëm midis standardeve të parashikuara dhe zbatimit të tyre real. Edhe pse janë bërë përmirësime të pjesshme ndër vite, transparenca proaktive mbetet e kufizuar në cilësi dhe përdorshmëri. Një pjesë e konsiderueshme e autoriteteve publike arrijnë një nivel të kënaqshëm formal përmbushjeje, por vetëm një numër shumë i vogël siguron transparencë të plotë dhe të përditësuar. Në

shumicën e rasteve, informacioni i publikuar është i fragmentuar, i papërditësuar ose i kufizuar në elementë bazikë, duke mos përmbushur funksionin e tij për llogaridhënie reale.

Problematika të ngjashme evidentohen edhe në lidhje me instrumente të tjera thelbësore, si regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, ndonëse janë krijuar në shumicën e institucioneve, shpesh rezultojnë të paplotë, të papërditësuar ose jo funksionale, duke kufizuar ndjeshëm transparencën reale.

Në aspektin procedural, të dhënat konfirmojnë se respektimi i afateve ligjore vijon të jetë problematik. Edhe pse kuadri ligjor është i qartë dhe i konsoliduar, praktika administrative karakterizohet nga vonesa të vazhdueshme dhe një nivel i pajustifikuar mospërgjigjeje. Kjo tregon se ekzistenca e procedurave standarde, siç parashikohet në *Planin e Integritetit*, nuk përkthehet automatikisht në funksionim efektiv të tyre.

Një dimension kritik i kësaj ndërthurjeje lidhet me rolin e Komisionerit si mekanizëm mbikëqyrës dhe garantues i zbatimit të ligjit. Ndërsa *Plani i Integritetit* e vendos këtë institucion në qendër të sistemit të integritetit, analiza e të dhënave më të fundit, të konfirmuara si nga monitorimi ynë, ashtu edhe nga raportimet zyrtare, tregon një performancë të kufizuar në disa tregues kyç. Numri i lartë i ankesave nuk shoqërohet me një nivel proporcional vendimmarrjeje formale; një pjesë shumë e vogël e ankesave përfundon me vendim, ndërsa pjesa tjetër trajtohet në mënyrë joformale ose mbetet pa një zgjidhje të plotë, të cilat për më keq raportohen si të zgjidhura nga Komisioneri. Kjo praktikë dobëson sigurinë juridike dhe pengon krijimin e një jurisprudence administrative të qëndrueshme, përpos cenimit të besueshmërisë.

Po ashtu, përdorimi i sanksioneve administrative mbetet sporadik dhe i kufizuar, pavarësisht shkeljeve të përsëritura nga autoritetet publike. Edhe në rastet kur vendimet merren, ekzekutimi i tyre nuk është gjithmonë i garantuar, duke treguar një dobësi strukturore në zbatim. Për më tepër, krahasimi midis të dhënave të monitorimit dhe raportimeve zyrtare ka evidentuar disa mospërputhje dhe paqartësi në mënyrën e raportimit, të cilat përbëjnë sinjale shqetësuese për nivelin e transparencës së vetë institucionit mbikëqyrës.

Në të njëjtën linjë, objektivat e *Planit të Integritetit* në lidhje me digjitalizimin dhe aksesin përmes teknologjisë mbeten të realizuara vetëm pjesërisht. Edhe pse janë krijuar instrumente dhe platforma të reja, si në nivel ligjor ashtu edhe institucional, përdorimi i tyre real mbetet i kufizuar dhe shpesh formal. Të dhënat e hapura, për shembull, publikohen në mënyrë të pjesshme dhe pa standardizim, ndërsa shumë institucione nuk ofrojnë informacion të strukturuar dhe të përdorshëm.

5.2. Konferenca Kombëtare për të Drejtën e Informimit – një analizë në dy plane

Në kuadër të analizës së veprimtarisë së Komisionerit, një element që meriton vëmendje të veçantë është organizimi i një tryeze, e quajtur “Konferenca VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit”, e cila, në vend që të shërbente si një moment reflektimi mbi gjendjen reale të transparencës, u shndërrua në një rast ilustrues të hendekut midis formës dhe përmbajtjes në këtë fushë.

Kjo tryezë mund të analizohet në dy plane të ndërlidhura: së pari, në planin organizativ dhe financiar; dhe së dyti, në planin substancial dhe politik, që lidhet me përmbajtjen reale të diskutimit dhe efektin e tij në adresimin e problematikave të transparencës.

Për organizimin e kësaj tryeze janë kryer shpenzime në vlerën totale prej 1,641,200 lekë, të ndara në shërbime arredimi, pajisje logjistike dhe pritje-përcjellje. Ky është një angazhim financiar jo i vogël për një aktivitet që, në thelb, duhet të funksionojë si forum llogaridhënieje dhe diskutimi mbi problemet reale të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, dhe jo si një dekor institucional.

Nga pikëpamja përmbajtësore, zhvillimi i kësaj konference nxori në pah një problem më të thellë, që është zhvendosja e fokusit nga transparenca si çështje strukturore drejt një performimi publik me karakter politik. Prania e Kryeministrit si figura qendrore e panelit, dhe dinamika e diskutimit, e vendosën atë në qendër të vëmendjes, ku ai u shfaq si kritik i sistemit, duke kërkuar rritjen e aplikimit të gjobave nga Komisioneri, dhe njëkohësisht si figurë që ofron zgjidhje për problemet e transparencës. Në kontrast, realiteti e paraqet Kryeministrinë si një prej autoriteteve publike më problematike.

Në këtë mënyrë, një çështje komplekse si e drejta për informim u reduktua në një dimension të vetëm, mungesën e sanksioneve, duke krijuar një narrativë të thjeshtuar dhe të përshtatshme për konsum publik. Në realitet, siç evidentohet edhe në këtë raport, problematikat kryesore të sistemit shkojnë përtej gjobave dhe lidhen me:

- numrin shumë të ulët të vendimeve të Komisionerit,
- përdorimin e kufizuar të mekanizmave detyrues,
- vonesat sistematike në trajtimin e kërkesave,
- dhe mungesën e një praktike të qëndrueshme administrative.

Një element veçanërisht problematik ishte edhe përbërja e panelit. Mungesa e disa aktorëve kyç të shoqërisë civile dhe praktikës së kësaj fushe, të cilët kanë kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe testimin e ligjit në praktikë, krijoi një hapësirë diskutimi të kontrolluar dhe të njëanshme. Kjo sugjeron se qëllimi i tryezës nuk ishte ballafaqimi me problematikat reale, por menaxhimi i narrativës publike mbi to.

Në këtë kontekst, konferenca krijoi një butafori skenike të mirëorganizuar, ku:

- Kryeministri shfaqej si figura qendrore dhe kritiku/zgjidhësi i problemeve,
- Komisioneri, ndonëse sipas ligjit një autoritet i pavarur, u paraqit në një rol pasiv, më pranë një institucioni vartës sesa një organi mbikëqyrës,
- ndërsa debati real mbi transparencën u zëvendësua nga një ndërveprim i kontrolluar politik, me pak hapësirë diskutimi.

Kjo dinamikë nxjerr në pah një problem themelor të funksionimit institucional, e cila shfaqet si mungesë e një distance reale midis autoritetit mbikëqyrës dhe ekzekutivit. Ndërsa ligji e koncepton Komisionerin si një organ të pavarur që duhet të kontrollojë administratën, në praktikë skena dhe narrativa e kësaj tryeze sugjerojnë një raport të përmbysur, ku presioni dhe orientimi vijnë nga lart, në mënyrë publike dhe performative.

Ky rast është një ilustrim i një tendence më të gjerë që evidentohet edhe në pjesët e tjera të këtij raporti, që ka investim në aktivitete formale dhe ekspozim publik, ndërkohë që problemet strukturore të transparencës mbeten të pazgjidhura.

Organizimi dhe zhvillimi i kësaj konference ngre një pyetje thelbësore për funksionimin e sistemit: A po përdoren instrumentet dhe burimet publike për të përmirësuar realisht transparencën, apo vetëm sa për të krijuar perceptimin për të?

5.3. Platforma “Transparent Albania”

Pas prezantimit të saj në dhjetor 2024, platforma “Transparent Albania” është konsoliduar si një ndërfaqe e dedikuar për publikimin e informacionit të lidhur me transparencën qeveritare. Ndryshe nga faza fillestare, ku ajo paraqitej kryesisht si një faqe që grumbullon linke, vlerësimi aktual tregon një përpjekje për strukturim më të qartë të përmbajtjes dhe përmirësim të paraqitjes vizuale. Megjithatë, analiza përmbajtësore tregon se ndryshimet mbeten më shumë në nivelin formativ sesa në thelb të transparencës.

Në aspektin e strukturës, platforma vazhdon të mbështetet kryesisht në grumbullimin e informacionit ekzistues nga faqet e institucioneve, ridrejtimin drejt sistemeve të tjera (si e-Albania apo portalet e të dhënave të hapura), si dhe publikimin e disa kategorive të informacionit të standardizuar (vendime, programe transparence, të dhëna buxhetore). Kjo tregon se platforma nuk ka evoluar në një sistem autonom transparence, por mbetet një faqe interneti ndërmjetëse.

Një nga problemet kryesore që vijon të konstatohet është fragmentimi i informacionit. Edhe pse platforma synon të krijojë një pikë të vetme akses, në praktikë përdoruesi detyrohet të kalojë nga një sistem në tjetrin për të marrë informacion të plotë. Kjo ul ndjeshëm efikasitetin dhe e bën përvojën e përdoruesit të ngjashme me navigimin e drejtpërdrejtë në faqet individuale të institucioneve.

Gjithashtu, nuk konstatohet një përmirësim domethënës në drejtim të integritetit të të dhënave në mënyrë të strukturuar dhe të krahasueshme, si dhe mundësitë të kërkimit të avancuar apo filtrimit të informacionit.

Në mungesë të këtyre elementëve, platforma nuk funksionon si një mjet analitik apo monitorues, por thjesht si një katalog informacionesh.

Një tjetër aspekt kritik mbetet fakti që platforma nuk ofron:

- të dhëna mbi përditësimin real të informacionit nga institucionet;
- sinjalizime për mungesë transparence;
- krahasime ndërmjet institucioneve;
- apo mekanizma feedback-u nga qytetarët.

Në lidhje me përmbajtjen, edhe pse mund të vërehet një zgjerim i kategorive të informacionit, cilësia e tyre lë për të dëshiruar. Në shumë raste informacioni është i përgjithshëm dhe jo i detajuar. Shpesh mungon përditësimi periodik dhe nuk ka standardizim në mënyrën e publikimit ndërmjet institucioneve. Kjo krijon një iluzion transparence, pa garantuar akses real dhe të përdorshëm në informacion. Në këtë kuptim, zhvillimi i platformës nuk ka ndryshuar në mënyrë thelbësore vlerësimin e bërë në vitin e kaluar. Edhe pse janë bërë përmirësime në paraqitje dhe organizim, nuk konstatohet një transformim substancial në funksionin e saj.

“Transparent Albania” mbetet më shumë një instrument iluzioni komunikimi institucional sesa një mekanizëm efektiv i transparencës dhe llogaridhënies. Për të kaluar nga një platformë prezantuese në një mjet real të qeverisjes së hapur, do të ishte e nevojshme:

- integrimi i të dhënave në një sistem unik dhe të kërkueshëm;
- vendosja e indikatorëve të matshëm të transparencës;
- automatizimi i përditësimit të informacionit;
- dhe krijimi i mekanizmave të kontrollit publik dhe feedback-ut.

5.4. Konventa e Tromsos dhe fillimi i monitorimit ndërkombëtar

Pas ratifikimit të Konventës së Tromsos në vitin 2022 dhe vlerësimit fillestar të përputhshmërisë ligjore nga Access Info Group (AIG), zhvillimet e vitit 2025 shënojnë kalimin nga një fazë deklarative në një fazë më të strukturuar monitorimi ndërkombëtar. Në këtë kuadër, AIG ka nisur raundin e parë të monitorimit tematik për shtetet palë, duke u fokusuar në një aspekt thelbësor të së drejtës për informim: menaxhimin dhe ruajtjen e dokumenteve zyrtare, në përputhje me nenin 9 të Konventës.

Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm, pasi Shqipëria përfshihet në një proces të drejtpërdrejtë vlerësimi mbi zbatimin praktik të standardeve të Konventës. Përmes një pyetësoi të detajuar drejtuar autoriteteve publike dhe njëkohësisht shoqërisë civile, AIG synon të analizojë nëse dokumentet zyrtare administrohen, regjistrohen dhe ruhen në mënyrë që të garantojnë akses real dhe efektiv për publikun. Fokusi mbi regjistrimin, arkivimin dhe trajtimin e dokumenteve, përfshirë edhe komunikimet elektronike, tregon një zhvendosje të vëmendjes nga kuadri ligjor drejt funksionimit konkret të administratës.


Fakti që ky proces përfshin edhe organizatat e shoqërisë civile si burim informacioni dhe verifikimi është veçanërisht i rëndësishëm, pasi krijon një mekanizëm të dyfishtë llogaridhënieje dhe shmang varësinë ekskluzive nga raportimi zyrtar i institucioneve. Në këtë mënyrë, monitorimi ndërkombëtar merr një dimension më kritik dhe më të balancuar.

Mbetet për t'u parë nëse ky mekanizëm ndërkombëtar do të përkthehet në ndryshime reale në praktikë. Fillimi i raportimit dhe monitorimit të rregullt përbën një mundësi të rëndësishme për të kaluar nga një qasje formale e transparencës drejt një sistemi më funksional dhe të verifikueshëm në praktikë.

5.5. Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit në sektorin publik


Zbatimi i ligjit nr. 33/2022 për të dhënat e hapura vijon të përbëjë një nga sfidat e dukshme në fushën e transparencës. Ndryshe nga viti 2024, ku aplikimi real i këtij ligji rezultonte shumë i kufizuar, të dhënat e vitit 2025 tregojnë një përmirësim të ndjeshëm në aspektin formal të krijimit të rubrikave për të dhënat e hapura. Një pjesë më e madhe e institucioneve tashmë kanë krijuar seksione të dedikuara dhe kanë filluar të publikojnë të dhëna, duke reflektuar një rritje të ndërgjegjësimit institucional për këtë detyrim ligjor.

Fig. 18 - Niveli i përmbushjes paraprake të publikimit të të dhënave të hapura



Megjithatë, analiza më e detajuar tregon se ky përmirësim nuk është i shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe mbetet i pabarabartë sidomos ndërmjet kategorive të ndryshme të autoriteteve publike. Sektori i drejtësisë paraqitet dukshëm më i avancuari, me një përqindje shumë të lartë institucionesh që publikojnë të dhëna të hapura, çka sugjeron një kulturë më të konsoliduar transparence dhe një nivel më të lartë organizimi institucional. Në kontrast, autoritetet e pushtetit ekzekutiv, si në nivel qendror ashtu edhe në atë të varësisë, shfaqin nivele dukshëm më të ulëta zbatimi, ndërsa pushteti vendor mbetet gjithashtu prapa, duke reflektuar dobësi strukturore dhe mungesë kapacitetesh.

Fig. 19 - Publikimi i të dhënave të hapura sipas kategorisë së autoriteteve publike



Edhe pse numri i institucioneve që nuk kanë fare rubrika për të dhënat e hapura mbetet i lartë (më shumë se gjysma) reduktimi i tij krahasuar me vitin e kaluar është një zhvillim pozitiv. Gjithsesi, ekzistenca e një rubrike nuk përkthehet domosdoshmërisht në transparencë reale. Në disa raste, rubrikat rezultojnë të paplotësuara ose përmbajnë të dhëna minimale, duke e kufizuar ndjeshëm përdorshmërinë e tyre nga publiku.

Në këtë kuptim, zhvillimi i vitit 2025 tregon një kalim nga një fazë e mungesës pothuasje të plotë të strukturave drejt një faze të institucionalizimit formal të tyre, por ende larg funksionalitetit të plotë. Sfida kryesore mbetet transformimi i të dhënave të hapura nga një detyrim formal në një instrument real për transparencë, inovacion dhe llogaridhënie. Për këtë, kërkohet jo vetëm publikim më i gjerë, por edhe standardizim i të dhënave, përditësim i rregullt dhe orientim drejt përdorimit të tyre nga publiku dhe aktorët e interesuar.

5.6. Agjencia për Media dhe Informim

Agjencia për Media dhe Informim, e krijuar si një strukturë në varësi të Kryeministrit me misionin për të garantuar transparencën e qeverisë dhe për të ndërmjetësuar komunikimin me publikun dhe median, vijon të paraqesë një rol të kufizuar në praktikë edhe gjatë vitit 2025. Pavarësisht funksionit të saj të deklaruar si pikë referimi për aksesin në informacion mbi veprimtarinë e Këshillit të Ministrave dhe institucioneve shtetërore, të dhënat tregojnë një përdorim të ulët dhe një ndikim të kufizuar në transparencë.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka trajtuar gjithsej 17 kërkesa, nga të cilat vetëm 7 janë kërkesa të mirëfillta për informacion, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga 6 kërkesa për komente dhe 4 kërkesa të deleguara tek institucione të tjera. Ky raport tregon se një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit të agjencisë nuk lidhet me garantimin e aksesit në dokumente apo të dhëna publike, por me funksione komunikimi dhe ndërmjetësimi institucional.

Roli i agjencisë rezulton gjithnjë e më shumë që të jetë më pranë një strukture komunikimi qeveritar sesa një mekanizmi që lehtëson aksesin në informacion publik. Edhe në rastet kur kërkesat për informacion janë trajtuar, përgjigjet janë dhënë shpesh në formë orientimi ose delegimi, duke e zhvendosur përgjegjësinë tek institucione të tjera dhe duke mos ofruar një zgjidhje të drejtpërdrejtë për kërkuuesin dhe duke mos krijuar konflikt kompetencash me autoritetet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

5.7. Aksesin në regjistrimet audiovizuale të seanceve publike – rasti M.M.

Një nga çështjet e rëndësishme të vitit 2025 në lidhje me të drejtën e informimit është kërkesa për akses në pamjet audiovizuale të një seance publike të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese. Padija e ngritur në këtë rast u rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që arsyetimi ende nuk është zbardhur, çka e bën të vështirë vlerësimin e plotë të vendimmarrjes së gjykatës. Megjithatë, vetë dinamika e çështjes dhe mënyra e trajtimit të saj nga autoritetet administrative nxjerr në pah një sërë problematikash sistematike.

Së pari, çështja ekspozon një paqartësi të thellë mbi kufijtë e informacionit publik në sistemin gjyqësor. Në këtë rast, një seancë që është zhvilluar publikisht dhe që është regjistruar nga vetë institucioni është trajtuar si informacion që nuk publikohet. Kjo krijon një kontradiktë themelore sepse nëse një proces është publik, por dokumentimi i tij nuk është i aksesueshëm, atëherë transparenca mbetet e pjesshme dhe formale.

Së dyti, çështja evidenton një problem të përsëritur në praktikën e Komisionerit, dhe konkretisht shmangia e vendimmarrjes. Në këtë rast, Komisioneri nuk ka marrë një vendim sipas nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, por është kufizuar në një përgjigje shpjeguese, duke e zhvendosur analizën nga ligji për të drejtën e informimit te ai për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një model që është konstatuar edhe në raste të tjera dhe që dobëson rolin e Komisionerit. Këtu shfaqet dobësia strukturore e mekanizmit të ankimit administrativ. Edhe kur paraqiten raste me rëndësi të lartë juridike dhe publike, sistemi nuk prodhon një përgjigje të qartë dhe të arsyetuar, por mbetet në nivelin e përgjigjeve të pjesshme ose shmangies së vendimmarrjes.

Problemi sistematik këtu është mungesa e vendimeve formale, jo thjesht si një çështje procedurale, por si një mënyrë për të shmangur krijimin e standardeve detyruese dhe për të kufizuar efektin e kontrollit administrativ.

Së treti, çështja nxjerr në pah një tendencë të rrezikshme që është zëvendësimi i testit të proporcionalitetit me një refuzim automatik të aksesit në informacion. Në vend që të analizohej në mënyrë konkrete nëse ekzistonte një interes privat që duhej mbrojtur dhe nëse ishte e mundur një zgjidhje proporcionale (p.sh. dhënie e pjesshme apo redaktimi), autoritetet zbatuan një ndalim të përgjithshëm, duke e trajtuar privatësinë si rregull dhe transparencën si përjashtim.

Së katërti, çështja ka një rëndësi të veçantë në raport me aksesin efektiv në drejtësinë ndërkombëtare. Në këtë rast, informacioni kërkohej për përdorim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çka e vendos çështjen përtej një kërkesë të zakonshme për informacion dhe e lidh atë me të drejtën për një mjet efektiv juridik. Refuzimi në këto kushte krijon rrezik që e drejta për informim të kthehet në një pengesë për ushtrimin e të drejtave të tjera themelore.

Për sa më sipër, rëndësia e kësaj çështjeje shkon përtej interesit individual të paditëses. Ajo ngre disa pyetje themelore për funksionimin e sistemit:

- A konsiderohen regjistrimet e seancave publike si informacion publik?
- A ka detyrim Komisioneri për të marrë vendime dhe të bëjë balancim midis të drejtave?
- A funksionon mekanizmi i ankimit si instrument efektiv apo si filtër formal?

Në mungesë të një arsytimi gjyqësor, këto pyetje mbeten ende të hapura, dhe Res Publica synon ta adresojë këtë çështje në gjykata më të larta për të krijuar një praktikë gjyqësore. Vetë mënyra se si është trajtuar kjo çështje deri tani konfirmon të paktën një nga gjetjet kryesore të këtij raporti: Problemi kryesor i sistemit nuk është mungesa e kuadrit ligjor, por mënyra selektive dhe shpesh formale e zbatimit të tij.

5.8. Aksesit në relacionet shpjeguese të vendimeve të Këshillit të Ministrave

Një tjetër çështje me rëndësi të veçantë për vitin 2025 lidhet me aksesin në relacionet shpjeguese të vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM). Në këtë rast, është kërkuar nga Kryeministria vënia në dispozicion e disa relacioneve që shoqërojnë vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave, kërkesë e cila është refuzuar.

Pas ankimit administrativ, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka pranuar ankesën dhe ka urdhëruar dhënien e informacionit, duke konfirmuar se këto dokumente përbëjnë informacion publik. Megjithatë, në vend që të zbatojë vendimin, Kryeministria ka zgjedhur ta kundërshtojë atë në gjykatë, duke mos e vënë në dispozicion informacionin dhe duke e shtyrë çështjen në një proces gjyqësor.

Ky rast nxjerr në pah disa problematika sistematike që prekin thelbin e transparencës në nivelin më të lartë të vendimmarrjes ekzekutive.

Së pari, ai evidenton një rezistencë institucionale ndaj transparencës në vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave. Relacionet shpjeguese nuk janë dokumente dytësore, por përbëjnë elementin kyç për të kuptuar arsyetimin, alternativat dhe logjikën që qëndron pas një vendimi normativ. Pa to, VKM-të mbeten të shkëputura nga konteksti dhe pa mundësi reale interpretimi nga publiku.

Së dyti, rasti nxjerr në pah një problem të rëndësishëm të zbatimit të vendimeve të Komisionerit. Edhe kur Komisioneri merr vendim në favor të transparencës, institucionet mund ta pezullojnë efektin e tij përmes ankimit gjyqësor, duke shtyrë në kohë aksesin në informacion. Në praktikë, kjo krijon një situatë ku e drejta për informim mbetet e varur nga kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, duke humbur vlerën aktuale. Problemi sistematik këtu është i dyfishtë: Nga njëra anë është mungesa e transparencës në dokumentet kyçe të vendimmarrjes, dhe nga ana tjetër, vihet re përdorimi i procesit gjyqësor si mekanizëm shtyrës për të mos dhënë informacionin.

Së treti, ky rast tregon një mungesë të kulturës së llogaridhënies në nivelin më të lartë të ekzekutivit. Në vend që të pranohet standardi i transparencës i vendosur nga Komisioneri, institucioni zgjedh ta sfidojë atë, duke krijuar një precedent që mund të ndiqet edhe nga autoritete të tjera publike.

Rasti në fjalë nuk është thjesht një konflikt administrativ mbi një kërkesë për informacion, por një indikator i një problemi më të thellë, të mungesës së transparencës në vetë procesin e prodhimit të vendimeve qeveritare.

Kjo çështje konfirmon një nga gjetjet kryesore të këtij raporti, që edhe kur ekzistojnë mekanizma ligjorë për garantimin e transparencës, efektiviteti i tyre mbetet i kufizuar përballë rezistencës institucionale, veçanërisht në rastet që lidhen me vendimmarrjen në nivelet më të larta të qeverisjes.

Çështja është aktualisht duke u ndjekur nga Res Publica.

5.9. Transparenca në lejet e ndërtimit dhe dokumentacionin shoqërues – rasti i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit

Një nga çështjet më domethënëse të vitit 2025 në lidhje me të drejtën për informim lidhet me aksesin në dokumentacionin shoqërues të lejeve të ndërtimit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në këtë rast, një organizatë investigative, OCCRNA, e cila operon faqen Shteg.org, ka kërkuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit vënien në dispozicion të një sërë dokumentesh që lidhen me disa projekte të rëndësishme ndërtimi, përfshirë lejet, kontratat e sipërmarrjes, dokumentacionin e pronësisë, preventivat e punimeve, raportet e ndikimit në mjedis dhe pagesat e taksave të infrastrukturës.

Pavarësisht natyrës së qartë publike të këtij informacioni, kërkesa është refuzuar pjesërisht nga autoriteti, ndërsa për pjesën tjetër është dhënë një përgjigje jo e plotë dhe e paqartë. Në vijim, edhe pas ankimit administrativ, Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk ka marrë një vendim, duke e detyruar paditësin t'i drejtohet gjykatës.

Ky rast nxjerr në pah disa nga problematikat më të thella të sistemit të transparencës në Shqipëri.

Së pari, evidentohet një prirje e përsëritur për të interpretuar në mënyrë të zgjeruar përjashtimet nga e drejta për informim. Refuzimi i dokumentacionit është mbështetur në argumente që lidhen me të drejtën e autorit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, pa u bërë një analizë konkrete për secilin dokument dhe pa u kryer balancimi i kërkuar nga ligji ndërmjet transparencës dhe interesave të mbrojtura. Në vend që përjashtimet të trajtohen si raste të kufizuara dhe të justifikuar, ato aplikohen në mënyrë të përgjithshme, duke u kthyer në mekanizëm justifikues për të refuzuar informacionin.

Së dyti, rasti evidenton një problem të njohur edhe nga monitorimet e mëparshme: publikimin formal të informacionit në vend të aksesit real në të. Autoriteti është mjaftuar me referimin e përgjithshëm të faqes së tij zyrtare, pa treguar adresën e saktë të dokumenteve dhe pa garantuar akses të plotë në përmbajtjen e kërkuar. Kjo praktikë krijon një situatë ku informacioni pretendohet se është publik, por në realitet mbetet i vështirë ose i pamundur për t'u përdorur.

Së treti, çështja nxjerr edhe një herë në pah një nga dobësitë më serioze të mekanizmit të ankimit administrativ që është mungesa e vendimmarrjes nga Komisioneri. Në këtë rast, mosmarrja e një vendimi nuk përbën thjesht një vonesë procedurale, por një dështim të ushtrimit të kompetencës ligjore. Në mungesë të një vendimi të arsyetuar, nuk krijohet asnjë standard detyrues për autoritetin publik dhe e drejta për informim mbetet e pambrojtur në praktikë deri sa të shprehet gjykata.

Së katërti, rëndësia e kësaj çështjeje lidhet drejtpërdrejt me natyrën e informacionit të kërkuar.

Dokumentacioni që shoqëron lejet e ndërtimit, kontratat, marrëdhëniet e pronësisë, kostot dhe vlerësimet mjedisore, përbën një nga burimet më të rëndësishme për të kuptuar mënyrën se si përdoren hapësirat urbane dhe fondet publike. Mungesa e aksesit në këto dokumente kufizon ndjeshëm mundësinë për kontroll publik dhe për analizë të informuar mbi zhvillimet urbane.

Së fundi, ky rast tregon qartë se refuzimi i informacionit nuk ka pasoja vetëm në planin formal, por ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e gazetarisë investigative dhe të shoqërisë civile. Në mungesë të dokumenteve burimore, puna kërkimore dhe raportuese bëhet e fragmentuar dhe e pasigurt, duke dobësuar llogaridhënien publike.

Çështja është aktualisht duke u ndjekur nga Res Publica.

5.10. Mbyllja e praktikave nga Komisioneri pa verifikim – rasti Res Publica kundër Komisionerit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Një tjetër çështje me rëndësi të veçantë për vitin 2025 lidhet me mënyrën se si Komisioneri për të Drejtën e Informimit trajton ankesat administrative, konkretisht në rastet kur autoritetet publike deklarojnë se nuk disponojnë informacionin e kërkuar.

Në këtë rast, Res Publica ka kërkuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit informacion të detajuar mbi menaxhimin e fondeve në kuadër të një projekti të financuar nga programet IPA, përfshirë alokimin e fondeve, pagesat ndaj nënkontraktorëve dhe listën e përfituesve. Pas një përgjigjeje negative nga institucioni, u paraqit një ankim administrativ.

Autoriteti publik deklaroi se nuk e disponon informacionin, ndërsa Komisioneri, pa kryer një verifikim të pavarur, e konsideroi ankesën si të përmbushur dhe ka mbyllur praktikën pa marrë një vendim substancial.

Sërish ky rast nxjerr në pah një nga problematikat më serioze të funksionimit të mekanizmit të ankimit administrativ.

Së pari, evidentohet një delegim faktik i funksionit të verifikimit te autoriteti publik. Në vend që të verifikojë në mënyrë aktive nëse informacioni ekziston dhe nëse refuzimi është i ligjshëm, Komisioneri mbështetet në deklarinimin e vetë institucionit, duke e kthyer procesin në një formalitet. Në këtë mënyrë, roli i tij si organ mbikëqyrës dobësohet ndjeshëm dhe ankimi administrativ humbet funksionin e tij real.

Së dyti, ky rast evidenton një problem të thellë të mungesës së hetimit administrativ. Në një situatë ku ekzistojnë indicie të qarta se informacioni duhet të ekzistojë, pasi lidhet me fonde publike dhe marrëdhënie kontraktore ku vetë institucioni është palë, mungesa e çdo verifikimi përbën një shmangie të detyrimit ligjor për të zbardhur faktet.

Së treti, kjo praktikë krijon një precedent të rrezikshëm, që mjafton që një institucion të deklarojë se “nuk e disponon informacionin”, për të shmangur detyrimin për transparencë. Në mungesë të një kontrolli real nga Komisioneri, kjo qasje mund të përdoret lehtësisht për të fshehur informacionin publik, veçanërisht në raste që lidhen me menaxhimin e fondeve dhe marrëdhëniet kontraktore.

Së katërti, çështja ka një rëndësi të veçantë në kontekstin e transparencës financiare. Informacioni i kërkuar lidhet me përdorimin e fondeve ndërkombëtare dhe pagesat ndaj nënkontraktorëve, një fushë ku transparenca është thelbësore për të garantuar llogaridhënie dhe për të parandaluar abuzimet. Refuzimi për të dhënë këtë informacion dhe pranimi i këtij refuzimi nga Komisioneri dobëson ndjeshëm mekanizmat e kontrollit publik.

Ky rast ilustron një model që përsëritet edhe në çështje të tjera të trajtuara në këtë raport, që praktika administrative mbyllet pa vendimmarrje të mirëfilltë dhe pa analizë të substancës së çështjes nga ana e Komisionerit. Në këtë mënyrë, edhe kur përdoret mekanizmi i ankimit, ai nuk prodhon një rezultat real dhe nuk krijon standarde të detyrueshme për administratën.

Çështja është aktualisht duke u ndjekur nga Res Publica.

5.11. Kufizimi i transparencës për shkak të proceseve gjyqësore – rasti i Bashkisë Himarë

Një tjetër çështje lidhet me përdorimin e proceseve gjyqësore si justifikim për kufizimin e të drejtës për informim. Në këtë rast, Res Publica kërkoi nga Bashkia Himarë dokumentacionin e plotë shoqërues të një lejeje infrastrukturore, përfshirë preventivat, raportet teknike dhe mjedisore, marrëveshjet dhe dokumentacionin mbështetës mbi të cilin është marrë vendimi.

Autoriteti publik refuzoi dhënien e informacionit duke argumentuar se çështja ishte në shqyrtim gjyqësor dhe duke sugjeruar që kërkuuesi të ndiqte procesin si palë e tretë. Komisioneri për të Drejtën e Informimit, në vend që të kryente një analizë të plotë të kushteve të kufizimit, ka vendosur rrëzimin e ankesës, duke e konsideruar situatën si një rast të lejueshëm kufizimi.

Ky rast evidenton një problematikë të rëndësishme në praktikën e transparencës: zgjerimi i padrejtë i përjashtimit që lidhet me “mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”.

Ligji për të drejtën e informimit parashikon se kufizimi është i mundur vetëm nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj procesit gjyqësor. Megjithatë, në këtë rast nuk rezulton të jetë bërë një analizë konkrete, sepse:

- nuk është identifikuar se cili dokument konkret cenon procesin,
- nuk është argumentuar se çfarë dëmi konkret mund të shkaktohej,
- dhe nuk është bërë asnjë balancim midis interesit publik dhe interesit të mbrojtur.

Në vend të kësaj, kufizimi është aplikuar në mënyrë të përgjithshme dhe automatike, duke e trajtuar ekzistencën e një procesi gjyqësor si arsye të mjaftueshme për refuzim.

Ky interpretim krijon një precedent problematik. Nëse çdo informacion që lidhet me një akt administrativ në shqyrtim gjyqësor konsiderohet i kufizuar, atëherë një pjesë e konsiderueshme e vendimmarrjes publike bëhet automatikisht e paprekshme nga transparenca, pikërisht në momentin kur ajo është më e rëndësishme për publikun.

Rëndësia e këtij rasti lidhet edhe me natyrën e informacionit të kërkuar. Dokumentacioni shoqërues i lejeve infrastrukturore përmban elementë thelbësorë për vlerësimin e ligjshmërisë dhe ndikimit të projektit, si raportet e ndikimit në mjedis, analizat teknike, marrëveshjet dhe strukturat e investimit. Këto dokumente përbëjnë bazën mbi të cilën ndërtohet vendimmarrja dhe që duhet të jetë e hapur për kontroll publik, veçanërisht në projekte që prekin interesat e komunitetit.

Në këtë kontekst, përdorimi i procesit gjyqësor si argument për mosdhënie informacioni krijon një efekt të kundërt me qëllimin e ligjit, sepse në vend që transparenca të shërbejë për të ndihmuar kontrollin publik dhe gjyqësor, ajo kufizohet pikërisht në momentin kur ky kontroll është në zhvillim.

Në tërësi, kjo çështje konfirmon një tjetër model të identifikuar në këtë raport, që është përdorimi i përjashtimeve ligjore në mënyrë të zgjeruar dhe jo të kontrolluar, për të kufizuar transparençën në çështje me interes të lartë publik.

5.12. Transparenca e vonuar dhe dëmshpërblimi për mosinformim – rasti i gazetarit Artan Rama kundër Bashkisë Librazhd

Një nga rastet më domethënëse për të kuptuar efektet reale të mosdhënies së informacionit është ai që lidhet me kërkesën e një gazetari investigativ për dokumentacionin mbi ndërtimin e një hidrocentrali në një zonë të mbrojtur në Bashkinë Librazhd. Në këtë rast, kërkesa për informacion nuk ka marrë përgjigje, ndërsa edhe ankimi administrativ pranë Komisionerit nuk është trajtuar me vendim, duke detyruar paditësin t'i drejtohet gjykatës.

Vetëm pas nisjes së procesit gjyqësor, pas një kohe të gjatë, autoritetet kanë vënë në dispozicion një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, duke pretenduar se detyrimi i tyre ishte përmbushur. Kjo situatë nxjerr në pah një problem të përsëritur në praktikë: dhënia e informacionit me vonesë, vetëm pas presionit gjyqësor, dhe trajtimi i kësaj si përmbushje e detyrimit ligjor.

Ky rast është i rëndësishëm sepse evidenton se problemi i transparençës nuk lidhet vetëm me refuzimin formal të informacionit, por edhe me kohën e dhënies së tij. Në rastin konkret, informacioni i kërkuar lidhej me një investigim mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe kishte një rëndësi të drejtpërdrejtë për publikun. Vonesa ka bërë që informacioni të humbasë aktualitetin dhe efektin e tij, duke e dëmtuar funksionin e gazetarisë investigative.

Në këtë kuptim, rasti konfirmon një problem sistematik, që e drejta për informim nuk cenohet vetëm nga refuzimi, por edhe nga vonesa në dhënien e informacionit.

Një element tjetër i rëndësishëm i kësaj çështjeje është dimensionin e dëmit të shkaktuar. Në këtë rast, paditësi ka kërkuar dëmshpërblim për dëmin jopasuror të shkaktuar nga mosdhënia e informacionit, duke argumentuar se kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në aktivitetin e tij profesional si gazetar investigativ dhe në reputacionin e tij. Kjo e vendos çështjen në një nivel tjetër analize, duke e lidhur të drejtën për informim jo vetëm me transparençën, por edhe me mbrojtjen e jetës profesionale dhe të lirisë së shprehjes.

Rasti evidentohet gjithashtu për rolin e Komisionerit, i cili nuk ka ushtruar kompetencat e tij në kohë dhe nuk ka marrë një vendim për ankesën, duke kontribuar në zgjatjen e situatës dhe në rëndimin e pasojave për kërkuesin e informacionit. Mungesa e ndërhyrjes në kohë nga autoriteti mbikëqyrës ka bërë që procesi administrativ të mos funksionojë si mekanizëm efektiv korigjues.

Në këtë kuptim, çështja ngre si problem themelor transparençën e vonuar, e cila në praktikë është e barasvlefshme me mungesën e transparençës.

Çështja është aktualisht duke u ndjekur nga Res Publica.

VI. TË DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Që prej vitit 2016, platforma publeaks.al vijon të shërbejë si një mekanizëm alternativ dhe praktik për ushtrimin e së drejtës për informim, duke u mundësuar qytetarëve, gazetarëve, studiuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile të kërkojnë dhe të marrin informacion nga autoritetet publike në mënyrë më të thjeshtuar dhe më të strukturuar. Nëpërmjet kësaj platforme, përdoruesit shmangin në një masë të konsiderueshme kostot kohore dhe procedurale që shpesh shoqërojnë ndjekjen individuale të kërkesave për informacion.

Gjatë viteve të funksionimit të saj, platforma ka shërbyer si një arkiv i hapur i kërkesave dhe përgjigjeve, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe aksesueshmërisë së informacionit publik. Deri në fund të vitit 2025, përmes publeaks.al janë adresuar mbi 2800 kërkesa për informacion, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme si mjedisi, ekonomia, prokurimet publike, buxheti, shëndetësia dhe sektorë të tjerë me interes publik. Një element i rëndësishëm i kësaj platforme është fakti se informacioni i marrë publikohet dhe mbetet i aksesueshëm për publikun, duke krijuar një bazë të dhënash të vlefshme për përdorim të mëtejshëm.


Platforma përdoret nga kategori të ndryshme individësh, me profile dhe qëllime të ndryshme. Një pjesë e përdoruesve janë gazetarë dhe profesionistë që e përdorin këtë instrument për qëllime investigative dhe informuese, ndërsa një pjesë tjetër janë qytetarë që kërkojnë informacion për çështje konkrete që lidhen me interesat e tyre personale ose komunitare.

Në vijim paraqiten të dhënat për përdorimin e platformës gjatë vitit 2025, të strukturuar sipas disa indikatorëve kryesorë:

- përdorimi i platformës Publeaks.al
- objekti i informacionit të kërkuar
- autoritetet publike ndaj të cilave janë drejtuar kërkesat
- arsimit i aplikuesve
- mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve

6.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al

Fig. 19 - Fluksi i vizitave në Publeaks.al



Nga të dhënat e raportuara për vitin 2025, vihet re një përdorim relativisht i qëndrueshëm i platformës gjatë gjithë vitit, me luhatje të moderuara mujore që ndjekin në përgjithësi ritmin e aktivitetit institucional dhe interesit publik. Muaji më aktiv rezulton Maji, i ndjekur nga Prilli dhe muajt e verës së hershme si Qershori dhe Korriku, periudhë që zakonisht përkon me rritjen e aktivitetit institucional dhe publikimin e materialeve me interes publik.

Në të kundërt, muaji me më pak vizita rezulton Shkurti dhe Gushti, duke reflektuar dy momente tipike të rënies së aktivitetit, të cilat janë fillimi i vitit, ku ritmi institucional është më i ulët, dhe periudha e pushimeve verore, kur interesi publik dhe angazhimi institucional zakonisht bien ndjeshëm.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përdorim më të ulët krahasuar me vitin 2024 dhe një shpërndarje më të sheshtë të trafikut gjatë vitit, pa kulme të theksuara si në periudhat e mëparshme. Kjo sugjeron një stabilizim të përdorimit të platformës, por njëkohësisht mund të jetë edhe një shenjë tjetër që reflekton trendin e evidentuar më sipër në këtë raport, të rënies së pjesëmarrjes së gazetarëve dhe aktivistëve në përdorimin e mekanizmave formalë të transparencës. Duke qenë se këta aktorë përbëjnë përdoruesit kryesorë të platformave si publeaks.al, një tkurrje e angazhimit të tyre përkehet drejtpërdrejt në ulje të trafikut dhe aktivitetit në platformë. Në këtë kuptim, ndryshimet në përdorimin e Publeaks.al nuk pasqyrojnë vetëm sjelljen e publikut në përgjithësi, por mbi të gjitha një dobësim të përdorimit të instrumenteve të strukturuar të transparencës nga aktorët që tradicionalisht kanë qenë më aktivë në kërkimin e informacionit me interes publik.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, pjesa dërrmuese e trafikut vijon të vijë nga Shqipëria (75%) dhe pjesa tjetër nga 58 shtete të ndryshëm, me përqendrim në qytetet kryesore si Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça dhe Fieri. Kjo shpërndarje gjeografike konfirmon se platforma përdoret kryesisht nga një audiencë e lokalizuar, e cila ka akses dhe interes për të ndjekur çështje të lidhura me transparencën publike.


Në tërësi, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se Publeaks.al mbetet një mjet funksional dhe i qëndrueshëm për kërkesat për informacion, por me një audiencë relativisht të specializuar.

Kjo përforcon idenë se përdorimi i platformës lidhet më shumë me nevoja specifike për transparencë dhe investigim, sesa me një përdorim të gjerë nga publiku i përgjithshëm.

6.2. Aplikantët sipas grupmoshave

Platforma Publeaks.al është konceptuar si një mjet i aksesueshëm për një gamë të gjerë përdoruesish, duke u ofruar mundësi individëve të çdo grupmoshe të kërkojnë dhe të marrin informacion nga autoritetet publike në mënyrë të strukturuar. Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se përdorimi i platformës shpërndahet në disa kategori moshe, me një përqendrim të dukshëm në grupmoshat aktive profesionalisht.

Fig. 20 - Aplikantët e Publeaks.al sipas moshës




Të dhënat tregojnë se përdoruesit kryesorë të platformës janë individë të grupmoshave 30–40 vjeç dhe 40–50 vjeç, të cilët përbëjnë së bashku gati dy të tretat e aplikantëve. Kjo shpërndarje sugjeron se platforma përdoret kryesisht nga individë me angazhim profesional dhe qytetar më të konsoliduar, si gazetarë, profesionistë etj. Duke qenë se këto kategori zakonisht përqendrohen pikërisht në grupmoshat 30–50 vjeç, fakti që përdorimi i platformës mbetet i përqendruar në këto grupmosha, ndërkohë që trafiku dhe numri i kërkesave janë në rënie, sugjeron një tkurrje të brendshme të këtij grupi përdoruesish.

Pjesëmarrja e grupmoshave më të reja dhe atyre mbi 50 vjeç mbetet më e kufizuar, duke treguar se përdorimi i këtij instrumenti nuk është ende i shpërndarë gjerësisht në të gjithë popullsinë. Kjo sugjeron nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit dhe lehtësimin e aksesit, në mënyrë që e drejta për informim të mos mbetet e kufizuar vetëm në një grup të ngushtë përdoruesish aktivë.

6.3. Aplikantët sipas arsimimit

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se përdorimi i platformës Publeaks.al mbetet i përqendruar kryesisht te individët me arsim të lartë, të cilët vijojnë të përbëjnë kategorinë më të interesuar dhe më aktive në kërkimin e informacionit nga autoritetet publike. Kjo prirje konfirmon se ushtrimi i së drejtës për informim kërkon një nivel të caktuar njohjeje, aftësish analitike dhe kapacitetesh për të ndjekur procedurat administrative.

Fig. 21 - Aplikantët e Publeaks.al sipas nivelit të arsimit




Për vitin 2025 vihet re edhe një rritje e pjesëmarrjes së individëve me arsim të mesëm, çka përbën një zhvillim pozitiv në drejtim të zgjerimit të bazës së përdoruesve. Megjithatë, ky zgjerim mbetet i kufizuar dhe nuk ndryshon ndjeshëm strukturën e përgjithshme të përdorimit.

Dominimi i qartë i përdoruesve me arsim të lartë tregon se, në praktikë, e drejta për informim mbetet një instrument i përdorur kryesisht nga një grup i informuar, duke reflektuar një shpërndarje jo të barabartë të aksesit dhe përdorimit të saj në shoqëri. Kjo nënkupton se transparenca nuk funksionon ende si një e drejtë universale në kuptimin praktik, por më tepër si një mjet i aktivizuar nga ata që kanë njohuritë dhe kapacitetet për ta përdorur.

6.4. Aplikantët/et sipas gjinisë

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se përdorimi i platformës Publeaks.al vijon të dominohet nga aplikantë meshkuj, të cilët përbëjnë 58% të totalit të përdoruesve. Krahasuar me vitin 2024, vihet re një ulje e pjesëmarrjes së aplikanteve femra, çka përforcon një prirje të vazhdueshme të një lloj mungese të balancimit gjinor në përdorimin e instrumenteve të transparencës.

Fig. 22 - Aplikantët/et e Publeaks.al sipas gjinisë



Kjo shpërndarje sugjeron se ushtrimi aktiv i së drejtës për informim mbetet më i përhapur te meshkujt. Kjo mund të lidhet me disa faktorë, përfshirë dallimet në angazhimin profesional, aksesin në informacion, si dhe nivelin e përfshirjes në çështje publike dhe institucionale.

Në këtë kuptim, të dhënat sipas gjinisë përforcojnë edhe më tej analizën mbi karakterin e segmentuar të përdorimit të platformës dhe të mekanizmave të transparencës në përgjithësi. Ashtu si në rastin e arsimit dhe grupmoshës, edhe këtu vihet re se e drejta për informim nuk përdoret në mënyrë të barabartë nga të gjitha grupet shoqërore.

VII. KONKLUZIONE

Panorama e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” vijon të karakterizohet nga një hendek i dukshëm midis kuadrit ligjor dhe funksionimit real në praktikë. Viti 2025, pavarësisht disa përmirësimeve të moderuara në tregues të caktuar, konfirmon se problemi kryesor mbetet jo tek ligji, por tek mënyra se si ai zbatohet dhe interpretohet nga autoritetet publike dhe mekanizmi mbikëqyrës.

Ndryshimet ligjore të vitit 2023 dhe zhvillimet në kuadër të integritimit evropian kanë krijuar një kornizë më të fortë normative, por kjo nuk është shoqëruar me një transformim të qendrueshëm të praktikës administrative. Transparenca në Shqipëri vijon të jetë më shumë një detyrim formal sesa një mekanizëm funksional i llogaridhënies.

7.1 Reagimi ndaj kërkesave për informacion

- Në vitin 2025, në testin e bërë me 200 kërkesa të monitoruara, 65% janë përmbushur plotësisht, 16% pjesërisht dhe 19% kanë mbetur pa përgjigje, duke treguar një përmirësim të moderuar krahasuar me vitin 2024, por duke ruajtur një nivel ende të lartë të mosrespektimit të ligjit.
- Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve ka zbritur në 16 ditë kalendarike, duke reflektuar një përmirësim, por ende mbi afatin ligjor.
- Pas ankimit administrativ, reagimi i institucioneve është përkeqësuar, me 22% të rasteve pa përgjigje edhe në këtë fazë, duke rikthyer situatën në nivelet e viteve 2022–2023.
- Kohëzgjatja mesatare e reagimit pas ankimit ka rënë në 12 ditë kalendarike, niveli më i ulët i dekadës, dhe ky përmirësim ndodh kryesisht nën presion institucional.
- Sistemi funksionon relativisht mirë për kërkesa rutinë, por has rezistencë të fortë në rastet me interes të lartë publik, ku informacioni shpesh refuzohet ose vonohet.

7.2 Programet e transparencës

- Në vitin 2025, 77% e institucioneve të monitoruar arrijnë një përmbushje “të kënaqshme”, 21% përmbushje të pjesshme dhe vetëm 2% pa program, duke konfirmuar konsolidimin formal të këtij instrumenti. Megjithëse ka përmirësim, ai mbetet kryesisht sasior dhe formal, ndërsa cilësia e informacionit mbetet e kufizuar.
- Informacionet më të publikuara janë ato formale (kontaktet, procedurat), ndërsa:
 - transparenca mbi kontratat, monitorimi i zbatimit të tyre, dhe
 - vendimmarrja, mbeten në nivele shumë të ulëta.
- Në disa kategori kyçe ka regres, si:
 - pagat dhe kualifikimet e zyrtarëve (37% → 26%)
 - procedurat e vendimmarrjes së autoritetit publik
- Pushteti vendor mbetet hallka më e dobët, me vetëm 48.4% përmbushje, pavarësisht rolit të tij të drejtpërdrejtë ndaj qytetarëve.

7.3 Strukturat për zbatimin e ligjit

- 98% e institucioneve kanë koordinatore, duke treguar përmbushje pothuajse të plotë.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve:
 - 66% përmbushje e kënaqshme
 - 29% pjesërisht
 - 7% pa regjistër
- Vetëm 13% e institucioneve kanë regjistër realisht funksional, ndërsa në pushtetin vendor ky nivel është pothuajse afër zeros. Kjo tregon se transparenca proaktive është institucionalizuar në formë, por ende jo në funksion.

7.4 Veprimtaria e Komisionerit

- Në vitin 2025 janë paraqitur 861 ankesa, në rënie për të katërtin vit radhazi.
- Rënia nuk reflekton domosdoshmërisht përmirësim, por mund të lidhet me dekurajimin e përdoruesve, veçanërisht gazetarëve dhe aktivistëve.
- Janë marrë vetëm 33 vendime, duke ruajtur një raport shumë të ulët ankesa/vendime (3.8%).
- 70% e vendimeve janë marrë jashtë afatit ligjor, duke treguar një regres në performancën e institucionit.
- Janë vendosur vetëm 2 gjoba për ankesat, duke konfirmuar përdorimin minimal të instrumenteve ndëshkuese.
- Janë vendosur vetëm 13 gjoba për programet e transparencës, kryesisht ndaj ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve të disa bashkive.
- Mekanizmi mbikëqyrës funksionon kryesisht si ndërmjetësues dhe jo si autoritet detyrues, duke dobësuar efektin e ligjit.
- Një pjesë e rasteve të raportuara si të zgjidhura përmes ndërmjetësimit nuk rezultojnë të jenë zgjidhur realisht në praktikë, duke krijuar një devijim midis raportimit institucional dhe përvojës së përdoruesve të ligjit.

7.6 Agjencia për Media dhe Informim dhe mekanizmat e tjerë

- AMI ka trajtuar 17 kërkesa në 2025, nga të cilat vetëm 7 për informacion.

- Agjencia konfirmohet që funksionon si strukturë komunikimi
- dhe nuk krijon konfuzion serioz me mekanizmat e të drejtës së informimit
- Platforma “Transparent Albania” mbetet një ndërfaqe formale, pa ndikim real në transparencë
- Ligji për të dhënat e hapura vijon të ketë zbatim të kufizuar.

7.7 Përfundim i përgjithshëm

Të dhënat e vitit 2025 konfirmojnë një model të qëndrueshëm:

- Transparenca proaktive është rritur në formë, por ende jo në përmbajtje
- Transparenca reaktive mbetet e varur nga presioni i ankimit te Komisioneri
- Komisioneri nuk prodhon efekt detyrues të qëndrueshëm, përmes vendimmarrjes së pakët dhe selektive
- Sanksionet janë pothuajse të papërdorura në atë masë që kërkon ligji
- Mekanizmat e rinj institucionalë nuk kanë rritur transparencën reale
- Rastet e veçantë të analizuar tregojnë disa modele të përsëritura:
 - Refuzimi përmes përjashtimeve të interpretuara në mënyrë të zgjeruar
 - Mosveprimi i Komisionerit dhe mungesa e vendimmarrjes
 - Përdorimi i procesit gjyqësor si mekanizëm zvarritjeje

Transparenca funksionon për informacion rutinë, por dështon për informacion të rëndësishëm me interes publik

Në këto kushte, roli i gazetarëve, shoqërisë civile dhe instrumenteve si Publeaks.al mbetet vendimtar për të mbajtur funksionale këtë të drejtë.

VIII. REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme ndër vite, rekomandojmë sa vijon:

Rekomandimi nr. 1

Kuvendi të rivendosë fokusin mbi të drejtën e informimit në procesin e vlerësimit të Komisionerit

Rezolutat vjetore të Kuvendit duhet të trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikat e transparencës së autoriteteve publike dhe jo të fokusohen vetëm në mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë qëllim, Kuvendi duhet të përfshijë në procesin e vlerësimit raportet e shoqërisë civile dhe të medias, si dhe të zhvillojë dëgjesa publike përpara miratimit të rezolutës.

Rekomandimi nr. 2

Komisioneri të marrë vendim për çdo ankesë dhe të shmangë mbylljen e praktikave pa analizë

Çdo ankesë e depozituar pranë Komisionerit duhet të përfundojë me vendim të arsyetuar, si forma e vetme që krijon standarde të detyrueshme për administratën dhe krijon premisa për zbatimin e sanksioneve në rast moszbatimi. Mbyllja e praktikave pa vendimmarrje dhe pa verifikim të pavarur dobëson funksionin e mekanizmit të ankimit.

Rekomandimi nr. 3

Forcimi i rolit hetimor të Komisionerit

Komisioneri duhet të ushtrojë në mënyrë aktive kompetencat e tij hetimore, duke verifikuar në mënyrë të pavarur deklaratimet e autoriteteve publike, veçanërisht në rastet kur pretendohet se informacioni nuk ekziston ose nuk disponohet. Delegimi faktik i këtij funksioni te vetë institucionet cenon thelbin e mbikëqyrjes.

Rekomandimi nr. 4

Rritja e përdorimit sistematik të sanksioneve

Në kushtet kur shkeljet e ligjit mbeten të përhapura, aplikimi i sanksioneve duhet të jetë më i shpeshtë dhe më i qendrueshëm. Vendosja e gjobave duhet të shoqërojë kryesisht

mospërgjigjen, si dhe vonesat, refuzimet e pajustificuara dhe moszbatimin e vendimeve të Komisionerit, në mënyrë që ligji të krijojë efekt real ndëshkues dhe parandalues.

Rekomandimi nr. 5

Vendosja e standardeve të detyrueshme për testin e interesit publik

Komisioneri dhe autoritetet publike duhet të aplikojnë në mënyrë të detyrueshme testin e balancimit midis interesit publik dhe përjashtimeve ligjore. Përjashtimet nuk duhet të aplikohen automatikisht, por vetëm pas një analize konkrete dhe të arsyetuar për secilin rast.

Rekomandimi nr. 6

Transparenca mbi dokumentet bazë të vendimmarrjes (relacione, kontrata, dokumentacion teknik)

Autoritetet publike, veçanërisht ata që vendosin mbi burimet natyrore dhe projektet projektet infrastrukturore, duhet të publikojnë jo vetëm aktet përfundimtare, por edhe dokumentet shoqëruese që justifikojnë vendimmarrjen, si relacionet shpjeguese, studimet dhe analizat teknike.

Rekomandimi nr. 7

Reduktimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore për aksesin në informacion

Çështjet që lidhen me të drejtën për informim duhet të trajtohen me procedurë të përsheptuar dhe, të jenë të ekzekutueshëm me një shkallë gjykimi. Zvarritjet shumëvjeçare e bëjnë të drejtën për informim praktikisht të pavlefshme.

Rekomandimi nr. 8

Funksionalizimi real i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve

Regjistri duhet të jetë i plotë, i përditësuar dhe të përmbajë dokumentacionin shoqërues të përgjigjeve. Komisioneri duhet të monitorojë jo vetëm ekzistencën, por edhe përmbajtjen e regjistrit.

Rekomandimi nr. 9

Zbatimi real i politikave për të dhënat e hapura

Autoritetet publike duhet të publikojnë të dhëna në formate të ripërdorshme, të përditësuara dhe të krahasueshme. Portali i të dhënave të hapura duhet të funksionojë si burim real informacioni dhe jo si katalog formal.

Rekomandimi nr. 10

Forcimi i rolit të gazetarisë dhe shoqërisë civile në monitorimin e transparencës

Duke qenë se përdorimi i ligjit po tregon shenja dobësimi, veçanërisht nga gazetarët dhe aktivistët, duhet të mbështeten iniciativa që nxisin përdorimin aktiv të së drejtës për informim.

* * *

Tiranë, Prill 2026

Qendra “Res Publica”
“E drejta e informimit 2025
Transparencë në vitrinë. Po në praktikë?”
Mbështetur nga:
National Endowment for Democracy
Tiranë, Prill 2026
60 faqe
Formati: 21 x 29.7 cm
Tirazhi 200 kopje



Nëse nuk të duhet
informacion
mos më skano!

